



**TRAJNIMI SIMULUES PËR IDENTIFIKIMIN,
REFERIMIN DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE
DHE HETIMIN PROAKTIV TË TRAFIKIMIT TË
QENIEVE NJERËZORE**

TRAJNIMI SIMULUES PËR IDENTIFIKIMIN, REFERIMIN DHE MBROJTJEN E VIKTIMAVE DHE HETIMIN PROAKTIV TË TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE

Botuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Bazuar në udhëzuesin “Trajnime bazuar në ushtrimet simuluese për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”, botuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, 2019.

SHKURT 2022

E drejta e autorit: ©Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.

Përmbajtja e këtij botimi mund të përdoret dhe të kopjohet lirisht për qëllime edukuese dhe jokomerciale, me kushtin që çdo riprodhim i tillë të shoqërohet me njohjen e Prezencës së OSBE-së dhe Zyrës së Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në autorësinë e botimit.

Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.


ISBN:

Ky botim u realizua nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri në kuadër të Programit “Transformimi i Përgjigjes Kombëtare ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore në dhe nga Shqipëria”, zbatuar nga gjashtë organizata lokale dhe ndërkombëtare që përfshijnë Zyrën e UNICEF në Shqipëri, Prezencën e OSBE-së në Shqipëri, “Terre des Homme”, “Tjetër Vizion”, “Vatra” dhe “Të Ndryshëm dhe të Barabartë”.

Ky dokument u financua nga Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në të nuk reflektojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar. Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Përmbajtja

1. Hyrje	7	Pjesa I - Metodologjia e trajnimit simulues	12	PJESA III – Zbatimi i ushtrimit	39
2. Mirënjohje	9	Një metodologji e re e të nxënit	12	Vështrim i përgjithshëm	
3. Informacion mbi Udhëzuesin	10	Të mësuarit nëpërmjet praktikës	12	mbi afatin kohor dhe agjendën	39
Qëllim i Udhëzuesit	10	Përparësitë e trajnimit simulues	15	Java përgatitore	39
Struktura e Udhëzuesit	11	Të mësuarit nëpërmjet përvojës	16	Java e simulimit	40
		PJESA II – Hartimi i trajnimit simulues	19	Realizimi i ushtrimit	41
		Komponentët e ushtrimeve simuluese	19	Organizmi dhe ndërveprimi i trajnuesve	42
				Roli i antenave si “sy dhe veshë”	43
				Veprime virtuale	44
				Diskutimet	45
				Shtojca	48



1. HYRJJE

Trafikimi i qenieve njerëzore përbën shkelje të të drejtave të njeriut, të vlerave themelore të shoqërive demokratike dhe një kërcënim madhor për sigurinë e rendin publik.

Megjithë përpjekjet e shteteve në nivelet kombëtare, rajonale e ndërkombëtare, trafikimi i qenieve njerëzore mbetet një aktivitet kriminal dinamik në përshtatje e sofistikim të vazhdueshëm. Çdo vit, mijëra njerëz, kryesisht gra dhe fëmijë, trafikohen me qëllim shfrytëzimin seksual apo forma të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë vendit të origjinës. Pothuajse të gjitha vendet në rajon janë vende të origjinës, tranzitit ose destinacionit, ose një kombinim i tyre. Lufta ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, duke angazhuar shtetet në reagim të përbashkët, bashkëpunim e bashkëveprim efikas të mekanizmave kombëtarë të ngritur prej tyre, mbetet në prioritetin e shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë OSBE-në.

Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, prej vitesh mbështet institucionet shqiptare në zhvillimin e legjislativitetit e të procedurave përkatëse për rritjen e kapaciteteve dhe përmirësimin e bashkëpunimit ndërinstitucional për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore në një qasje të

bazuar në të drejtat e njeriut. Në bashkëpunim me zyrën e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri zhvilloi trajnimin e parë simulues në Shqipëri për identifikimin dhe hetimin e Trafikimit të Qenieve Njerëzore. Trajnimi erdhi pas një sërë trajnimesh ndërkombëtare dhe kombëtare të organizuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, ku janë trajnuar qindra profesionistë nga pothuajse çdo Shtet pjesëmarrës i OSBE-së dhe Partner i OSBE-së për Bashkëpunim.

Pas një pune gati dy vjeçare për ndërtimin e skenarëve e situatave, shkëmbimeve të ndryshme midis pjesëmarrësve dhe shtjellimit të bazës ligjore, trajnimi mblodhi mbi 50 pjesëmarrës të fushave dhe institucioneve të ndryshme si dhe aktorë profesionistë që interpretuan trafikantët dhe viktimat. Qëllimi i trajnimit ishte nxitja e bashkëpunimit midis strukturave të ndryshme shtetërore dhe atyre të shoqërisë civile për të identifikuar viktimat e trafikimit dhe për të hetuar trafikantët. Trajnimi u dha një mundësi profesionistëve të ndryshëm të zbatonin në praktikë parimet e anti-trafikimit, të cilat nuk trajtoheshin në kurse standarde trajnimi, si për shembull asistencë e

personave të trafikuar pavarësisht bashkëpunimit ose jo të tyre për denoncimin e trafikantëve, nevojat e veçanta të fëmijëve viktimat të trafikimit apo veprimet proaktive nga ana e oficerëve të policisë gjyqësore nën drejtimin e prokurorëve.

Kjo metodologji e re e të mësuarit bazohet në veprime që simulojnë situata reale të trafikimit të qenieve njerëzore. Përgjatë tri ditëve të trajnimit pjesëmarrësit në trajnim testuan njohuritë e tyre duke vepruar në situata të ngjashme në punën e përditshme, por në të ashtuquajturin “mjedis të sigurt”, pa qenë nevoja që të marrin masa për pasojat e veprimeve të tyre. Punonjës të policisë, shërbimeve sociale, prokurorë, inpektorë të punës e avokatë të viktimave trajtuan raste të simuluar të trafikimit të qenieve njerëzore, të rikrijuar nga aktorë profesionistë.

Trajnimi si një metodë e vlefshme mësimdhënieje i dha mundësi profesionistëve të kapërcejnë pengesat praktike në punën e tyre të përditshme kundër trafikimit. Metodologjia e përfshirjes së disa strukturave në vetvete synoi që profesionistët të punojnë në mënyrë ndër sektoriale dhe jo të izoluar dhe të zbatojnë parime të drejtave të njeriut në çdo fazë të identifikimit të viktimave dhe hetimit. Ndërveprimi me njëri-tjetrin për të gjetur zgjidhjet më të përshtatshme për raste të trafikimit të fëmijëve apo personave të rritur ishte baza e metodologjisë së trajnimit. Pjesëmarrësve i'u kërkua të reagonin në një sërë ngjarjesh sipas skenarëve të parapërgatitura nga grupi i ekspertëve. Në trajnimin simulues u intervistuan fëmijë e të rritur, viktimat e mundshme trafikimi, të interpretuar nga aktorë profesionistë, duke zbatuar një sërë ligjesh dhe procedurash që synojnë mbrojtjen e interesit më të lartë të fëmijës dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rastet e trajtuara ishin komplekse dhe përfshinin viktimat vendase dhe të huaja duke i vënë pjesëmarrësit në situata të vështira që kërkonin një reagim të menjëhershëm, bazuar në ligjet dhe procedurat anti-trafikim.


Përgjatë trajnimit, u testuan metoda të reja hetimi të përbashkët midis oficerëve të policisë së kufirit dhe inspektorëve të punës për zbulimin e rasteve të trafikimit me qëllim shfrytëzimin për punë. U vunë në zbatim protokollat ekzistues si dhe u hartuan marrëveshje që në të ardhmen mund të shërbejnë për avancimin e mëtejshëm të masave anti-trafikim në Shqipëri.

Trafikantët e viktimave, gjithashtu aktorë, i dhanë një kontekst tepër real trajnimit duke i vendosur shpesh pjesëmarrësit në vështirësi thuajse reale për të hetuar ngjarjet dhe për të shpëtuar viktimat.

Trajnimi krijoi mundësi për pjesëmarrje aktive dhe të drejtpërdrejtë të të gjithë pjesëmarrësve që mësuan nga kolegët e të njëjtës fushë ose të fushave të ndryshme. Në trajnim u vu theksi në bashkëpunimin midis agjencive të ndryshme për identifikimin e viktimave të trafikimit dhe për referimin e asistencën e tyre në përputhje me parimet e të drejtave të njeriut. Aksionet policore për shpëtimin e viktimave të trafikimit dhe arrestimin e trafikantëve ishin pjesa më dinamike dhe emocionuese e trajnimit. Operacionet hetimore përfunduan në arrestimin e trafikantëve të viktimave fëmijë dhe të rritur si dhe në shpëtimin e personave të trafikuar. Për të reflektuar mbi veprimet e ndërmarra, në fund të secilës ditë, trajneri ekspert për secilën fushë diskutonte dhe reflektonte me skuadrën përkatëse mbi objektivat e arritura, si dhe mbi atë çka mund të përmirësohet.

Ushtrimi simulues i trajnimit bazohet në metodologjinë e Udhëzimit të zhvilluar nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për Luftën ndaj Trafikimit të Qenieve Njerëzore, që udhëhoqi përkrah Prezencës së OSBE-së zhvillimin e këtij formati trajnimi në Shqipëri. Ky Udhëzues praktik është hartuar që të kontribuojë drejt qëndrueshmërisë së trajnimit simulues

të zhvilluar në Shqipëri, duke ofruar nëpërmjet këtij Udhëzuesi një përshkrim të detajuar të metodologjisë së trajnimit, përvojave të ekspertëve dhe stafit të OSBE-së të përfshirë në konceptimin dhe zhvillimin e tij si dhe mësimet e nxjerra gjatë procesit kompleks për hartimin e trajnimit të përshtatur me kontekstin shqiptar. Informacioni mbi trajnimi gërshetohet me konceptet dhe parimet ndërkombëtare, veçanërisht ato të OSBE-së si dhe legjislacionit shqiptar për masat kundër trafikimit të qenieve njerëzore.



“Njësia e Policisë” arreston një trafikant të dyshuar.

2. MIRËNJOHJE

Ky projekt i rëndësishëm nuk do të ishte realizuar pa kontributin dhe përkushtimin e grupit të punës së ekspertëve që zhvilluan këtë metodologji trajnimi. Në mënyrë të veçantë grupi i punës i përbërë nga ekspertë shqiptarë dhe ndërkombëtarë si Juliana Rexha, Tetiana Rudenko, Katharina Thon, David Mancini, Veikko Mäkelä, Luljeta Ikonimi, Doloreza Musabelliu, Anila Trimi, Mariana Meshi, Jonita Kabashi për hartimin e skenarëve, përshtatjen e bazës ligjore dhe për zbatimin e trajnimit. Ekspertë të tjerë të përfshirë në trajnim si Lutfi Minxhozi, Ilirjan Balla, Irida Qosja sollën qasjen ndërsektoriale dhe

ndërthurjen e proceduave të disiplinave të ndryshme në rastet e trafikimit të trajtuara në trajnim.

Simulimi arriti objektivat e tij edhe në sajë të kontributit të jashtëzakonshëm të aktorëve në rolet e trafikantëve dhe viktimave, të përgatitur nga regjizori Eol Çashku. Falënderime të veçanta i takojnë stafit të OSBE-së që asistoi në përgatitjen e cdo faze të trajnimit, në veçanti Kristina Doko si dhe Shila Bandilli e Megi Mazreku.

Ky trajnim u realizua falë mbështetjes financiare të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.



DIREX (Drejtimi i Ushtrimit), grupi i punës i përbërë nga ekspertë shqiptarë dhe ndërkombëtarë.

3. INFORMACION MBI UDHËZUESIN

Qëllim i Udhëzuesit

Ky Udhëzues synon ti vijë në ndihmë institucioneve shqiptare për të zhvilluar metoda të reja trajnimi në kuadrin e masave kundër trafikimit të qenieve njerëzore, duke kontribuar kështu në rritjen e kapaciteteve strukturave të ndryshme për t'u ofruar mbrojtjen e duhur viktimave të trafikimit dhe përmirësuar hetimin e trafikantëve.

Udhëzuesi është hartuar në bazë të Udhëzuesit Praktik të OSBE-së për Trajnimin bazuar në ushtrimin simulues për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, botuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore¹ dhe mësimet e nxjerra si rezultat i zhvillimit dhe zbatimit për herë të parë në Shqipëri të trajnimit Simulues, nga ana e Prezencës së OSBE-së në Shqipëri.

Në Udhëzues janë reflektuar të gjitha çështjet praktike të ndeshura nga OSBE-së në trajnimet e mëparshme dhe në veçanti në trajnimin simulues të organizuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri. Qëllimi i i Udhëzuesit është që nëpërmjet shtjellimit të metodologjisë dhe

¹ https://www.osce.org/files/f/documents/0_413510/2/1.pdf



Udhëzuesi Praktik i OSBE-së për Trajnimin bazuar në ushtrimin simulues për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, botuar nga Zyra e Përfaqësuesit të Posaçëm dhe Koordinatorit të OSBE-së për luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore.

hapave të punës për realizimin e një trajnimi simulues të posacëm në fushën e anti-trafikimit dhe kontekstin shqiptar, ti shërbejë institucioneve shqiptare për zhvillimin e trajnimeve të ngjashme në këtë fushë. Në të pasqyrohen metodologjia e trajnimit, mënyra e përzgjedhjes së pjesëmarrësve dhe grupit të punës, hartimi i roleve dhe skenareve mbi të cilat zhvillohet trajnimi, baza ligjore por dhe logjistika e trajnimit dhe aspekte të tjera praktike.

Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe ndjekjen penale të trafikantëve, bazuar në një qasje ndërdisiplinare, e cila mishërohet në të drejtën ndërkombëtare dhe në legjislacionin shqiptar. Trafikimi i qenieve njerëzore është një fenomen kompleks, shkaqet e të cilit përfshijnë faktorë ekonomikë, shoqërorë, kulturorë, politikë dhe personalë.

Qasja ndërdisiplinare në fushën e anti-trafikimit parashikon ndërhyrje të specializuar sektoriale dhe ndërsektoriale, si një detyrim i të gjitha institucioneve shtetërore dhe joshtetërore që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e anti-trafikimit. Në realitet, kjo qasje paraqet sfida për shkak të mandateve të ndryshme që kanë institucionet dhe kuadrit ligjor që rregullon funksionimin e tyre.

Struktura e Udhëzuesit


Udhëzuesi është organizuar në tri pjesë:

PJESA I – Njohja me metodologjinë e trajnimit simulues. Kjo pjesë synon të sjellë formatin dhe metodën e ndërtimit dhe zbatimit të trajnimit simulues bazuar në të mësuarit përmes praktikës. Nisur nga natyra e fenomenit të trafikimit, metodologjia e këtij trajnimi bazohet në konceptin e punës ndërsektoriale dhe thekson bashkëpunimin mes shumë strukturave të ndryshme anti-trafikim.

PJESA II – Programi i trajnimit simulues. Ky kapitull që përshkruan hapat nga përzgjedhja e formave të trafikimit që do të trajtohen, anëtarët e grupit të punës, përzgjedhjen dhe shkrimin e historive dhe skenarëve, përmbledhjen e legjislacionit, përcaktimin e objektivave të të mësuarit deri tek përzgjedhja dhe trajnimi i aktorëve që do të interpretojnë skenarin.

PJESA III – Zbatimi i ushtrimit. Ky kapitull përmban disa këshilla praktike për realizimin e ushtrimeve, përfshirë strukturën dhe funksionimin e tyre. Monitorimi dhe vlerësimi i një ushtrimi teksa ai zhvillohet është themelor për përvojën e të mësuarit dhe për t'u dhënë komente e vlerësime pjesëmarrësve. Në këtë seksion paraqiten disa mjete të rëndësishme praktike që përfshijnë këto koncepte.

Në fund të këtij udhëzuesi jepen disa formularë dhe modele që shërbejnë si referencë dhe orientim.



Ndarja e pjesëmarrësve në njësitë përkatëse.

PJESA I METODOLOGJIA E TRAJNIMIT SIMULUES



Operacioni i i “Njësisë e Policisë” për kapjen e trafikantëve të dyshuar.

Një metodologji e re e të nxënit

Për shkak të natyrës komplekse të këtij fenomeni, zhvillimeve dinamike dhe kuadrit ligjor, trajnimet e strukturave anti-trafikim janë të domosdoshme për të siguruar përditësimin e vazhdueshëm të profesionistëve. Në realitet shpesh është e vështirë që ekspertët të trajnohen në mënyrë të tillë që të përballojnë dinamikën e përditshme dhe ngarkesën e punës. Përgjithësisht, trajnimet e realizuara drejtpërdrejt apo ato nëpërmjet platformave të internetit pasqyrojnë informacionin teorik dhe atë praktik në një gjendje statike dhe teorike. Në qendër të këtyre trajnimeve është shpesh lektori dhe më pak pjesëmarrësit.

Të mësuarit nëpërmjet praktikës

Natyra e fenomenit të trafikimit kërkon që masat anti-trafikim të zbatohen nga disa institucione dhe nga organizatat e shoqërisë civile. Bashkëpunimi është shpesh një sfidë si përsa i përket bashkëpunimit kombëtar dhe atij ndërkombëtar. Mbrojtja e të drejtave të viktimave të trafikimit në raport me ndjekjen penale është një prej çështjeve më sfiduese për profesionistët anti-trafikim dhe jo rrallë është e vështirë që t'i trajnosh ekspertët në mënyrë të tillë që të përballen me dinamikat

dhe presionet e përditshme të punës kundër trafikimit. Pikërisht për këtë arsye OSBE-ja, për të plotësuar leksionet e përgjithshme të ndërgjegjësimit dhe kurset e trajnimit, ka hartuar një metodë novatore trajnimi, bazuar në metodologjinë e “të mësuarit nëpërmjet praktikës.”

Trajnimet e bazuara në ushtrimet simuluese kanë të bëjnë me të vepruarin në situata reale. Kjo u jep mundësi pjesëmarrësve në trajnim që të provojnë vendimmarrjen në situata të ndryshme me të cilat përballen në punën e përditshme, por në të ashtuquajturin “mjedis të sigurt”. Duke qenë një metodë trajnimi e fokusuar tek pjesëmarrësi, ajo vendos pikërisht pjesëmarrësit në trajnim në qendër të procesit të të mësuarit (dhe jo trajnuesin).

Ndryshe nga auditorët e zakonshme, trajnuesit ndërveprojnë me pjesëmarrësit më shumë si lehtësues. Gjatë këtij trajnimi, pjesëmarrësit në trajnim merren me raste të simuluar të trafikimit të qenieve njerëzore të rikrijuar nga aktorë profesionistë. Pjesëmarrësve u kërkohet të reagojnë në një sërë ngjarjesh të skenarit (“të japin kontribute”), të kryejnë detyra konkrete, të shpjegojnë radhën e ngjarjeve, të rindërtojnë historinë mbi bazën e së cilës ndërtohet një rast, si dhe të përpunojnë të dhënat e hetimit.

Për të zbatuar procedurat anti-trafikim, pjesëmarrësit duhet të komunikojnë dhe të koordinohen mes strukturave të ndryshme. Bashkëpunimi ndër-institucional është thelbësor për arritjen e objektivave të trajnimit.

Trajnimi me bazë simulimin krijon mundësi për përfshirje aktive dhe të drejtpërdrejtë, për të mësuar nga kolegët e së njëjtës fushë ose të fushave të ndryshme. Pjesëmarrja e një game të gjerë profesionistësh, si oficerët e sektorëve të ndryshëm të policisë, prokurorë, punonjës socialë të punonjës të mbrojtjes së fëmijës, si dhe avokatë e përfaqësues të qendrave që asistojnë viktimat e trafikimit, apo inspektorë të punës, siguron



Operacioni i policisë për kapjen e trafikantëve të dyshuar.

trajtimin ndër-sektorial të rasteve të trafikimit. Por veç këtij reflektimi të parimit ndërsektorial, pjesëmarrësit në trajnim përballen me këndvështrime dhe metoda të ndryshme pune brenda fushës së tyre të ekspertizës dhe jo vetëm. Trajnimi organizohet në mënyrë të tillë që në fund të secilës ditë, trajneri ekspert për secilën fushë mblihet me skuadrën përkatëse dhe sëbashku reflektojnë duke diskutuar mbi objektivat e arritur, si dhe mbi atë çka mund të përmirësohet.

Arritja e objektivave të trajnimit bazohet në komunikimin e vazhdueshëm dhe koordinimin mes ekipeve. Nëse nuk e bëjnë këtë, nuk i arrijnë objektivat e vendosur.

Ushtrimet që janë pjesë e simulimit përfshijnë:

- **Reflektim i situatave të jetës reale** që i lejon pjesëmarrësit të përjetojnë vendimmarrje në të ashtuquajtura “mjedise të sigurta”, duke i vendosur pjesëmarrësit në trajnim në qendër të procesit të të nxënimit (dhe jo trainerin/ët). Trajnerët mund të bashkëveprojnë, gjithashtu edhe “prapa skenës” me pjesëmarrësit, duke luajtur më shumë rolin e lehtësuesit në krahasim me leksionet në klasë. Gjatë këtij ushtrimi, pjesëmarrësit kalojnë raste të simuluar të trafikimit të qenieve njerëzore të rikrijuara nga aktorët. Pjesëmarrësve u kërkohet të reagojnë

ndaj një vargu ngjarjesh në skenar (“inputet”), të trajtojnë detyra konkrete, të kuptojnë sekuencën e ngjarjeve, të rindërtojnë ngjarjen prapa një çështje, dhe të përpunojnë, ndër të tjera, të dhëna hetimore. Në mënyrë që të ekzekutojnë në mënyrë efektive hapat e kërkuar, ata duhet të komunikojnë dhe bashkërendojnë në ekipe dhe disiplina të ndryshme, përndryshe nuk do t’i arrijnë objektivat e përcaktuara;

- **Një mënyrë për të nënvizuar parimet e antitrafikimit** në praktikë, të cilat nuk trajtohen në kurse standarde trajnimi, p.sh. ndihma për viktimat pa marrë parasysh bashkëpunimin e tyre me sistemin e drejtësisë penale; hartimi i protokolleve të përbashkëta midis

oficerëve të kufirit dhe migracionit dhe inspektorëve të punës; efektiviteti i hetimeve proaktive.

- **Një platformë për punën ndërinstitutionale.** Gjatë simulimit, ekipet individuale për secilën disiplinë do të duhet të bashkëveprojnë me ekipe të tjera, duke vënë kështu në praktikë konceptin e ndërhyrjeve ndërsektoriale. Në fund të çdo dite trajnimi, i ushtrimi/simulimi reflektohen në përmbledhjet e punës së ditës; të gjithë ekipet bëjnë përmbledhjen brenda grupit të tyre të ngushtë profesional dhe më pas në seancë plenare diskutohen vështirësitë e hasura dhe zgjidhjet e bëra.



Pjesëmarrësit gjatë ditëve të trajnimit.

- Një metodë të vlefshme trajnimi që mund t'i ndihmojë profesionistët të kapërcejnë pengesat praktike të punës së përditshme kundër trafikimit, përfshirë “mos ndarjen e informacionit” midis agjencive.
- Një mënyrë të fuqishme për të ndërtuar rrjete të gjera, praktike të profesionistëve antitrafikim në nivel. Pjesëmarrësit janë në gjendje të krijojnë lidhje dhe marrëdhënie profesionale dhe personale gjatë komponentëve intensivë të kursit.
- Në nivelin kombëtar, simulimi është një mënyrë për të provuar dhe për të vërtetuar funksionimin e Procedurave Standarde të Veprimit në praktikë duke nxitur sugjerime për rishikimin apo përmirësimin e tyre.

Përparësitë e trajnimit simulues

Trajnimi simulues mundëson përvetësimin në praktikë të parimeve antitrafikim, të cilat nuk adresohen lehtë në kurset standarde të trajnimit.

Këto parime përfshijnë asistencën ndaj viktimave, pavarësisht bashkëpunimit të tyre me sistemin e drejtësisë penale; identifikimin e shpejtë dhe efikas të viktimave të trafikimit; bashkëpunimin efikas me



Intervista e parë e “fëmijëve viktimë të trafikimit”.

organizatat e shoqërisë civile; përmirësimin e nevojave të veçanta të fëmijëve viktimë; si dhe balancimin e ndërhyrjes në rastet e migrantëve të cilët kanë nevojë për mbrojtje ndërkombëtare. Në rastin e ushtrimit simulues të zbatuar në Shqipëri, këto parime u reflektuan në pasqyrimin e historive që përfshinin të mitur si viktimë trafikimi, viktimë të huaja me nevojë për mbrojtje të posaçme ndërkombëtare, si dhe viktimë të trafikimit me qëllimin shfrytëzimin për punë, por me qëndrim të rregullt në vendin e destinacionit. Për trajtimin e rasteve të tilla,

pjesëmarrësit duhet të zbatojnë parimet kryesore në fushën anti-trafikim dhe të mësojnë nëpërmjet aplikimit të tyre në situata reale.

Trajnimi ofron për pjesëmarrësit një mundësi unike për t'u ballafaquar me raste komplekse të trafikimit, duke ndërvepruar në mënyrë intensive me profesionistë të institucioneve të ndryshme, përgjithësisht që reflektojnë përbërjen e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat e Trafikimit. Për shembull, nëse në trajnim

përfshihet një histori trafikimi me qëllim shfrytëzimin për punë, inspektorët e punës duhet të ndërveprojnë me policinë dhe prokurorinë që nga momenti i identifikimit të rastit dhe deri në ndalimin e autorëve. Në fund të çdo dite trajnimi, të gjitha skuadrat diskutojnë, fillimisht brenda secilës skuadër profesionistësh dhe më pas në një sesion të përbashkët, mbi vështirësitë që kanë hasur si dhe zgjidhjet përkatëse.

Metodologjia e përfshirjes së disa strukturave në vetvete synon që profesionistët të punojnë në mënyrë ndërsektoriale dhe jo të izoluar.

Për shembull, krahas hetimit të veprës së trafikimit përfshihet dhe hetimi ekonomik dhe pasuror në mënyrë që të gjurmohen asetet financiare të paligjshme të autorëve që kanë ardhur si rezultat i veprimtarisë së trafikimit. Është e domosdoshme që oficerët e kimit ekonomik të hetojnë nën drejtimin e prokurorëve, si dhe që hetimi financiar të shtrihet në të gjitha asetet që mund të ketë personi i dyshuar brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një shembull tjetër i përfshirjes së strukturave është dhe roli aktiv që i jepet Punonjësit të Mbrojtjes së Fëmijës në çdo hap të adresimit të nevojave të fëmijës gjatë trajnimit. Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës, në cilësinë e trajtuesit të rastit, është struktura kyç që komunikon me

2 Kjo pjesë mbështetet në Qendrën për Aktivitetet e Zhvillimit dhe Popullatës (CEDPA), Trajnimi i trajnuesve për zhvillim, 1995.

fëmijën, familjen, punonjësit e policisë dhe shërbimet e asistencës që i ofrohen fëmijës.

Trajnimi simulues kontribuon në fuqizimin e bashkëpunimit mes profesionistëve të cilët ballafaqohen me sfidat e punës së tyre të përditshme në një ambient të sigurt.

Gjatë hapave intensivë të një kursi të tillë pjesëmarrësit kanë mundësi të lidhen dhe të ndërtojnë marrëdhënie profesionale dhe personale. Ky format nxit një lloj angazhimi që shkon përtej mundësive të udhëzimeve në klasë përmes leksioneve sistematike. Në shumë raste, në përvojën e OSBE-së, marrëdhëniet profesionale janë ndërtuar pikërisht përmes këtyre ushtrimeve simuluese, marrëdhënie që më pas janë shfrytëzuar në operacione në jetën reale.

Të mësuarit nëpërmjet përvojës


Për të qenë i efektshëm, çdo lloj trajnimi duhet të jetë në gjendje të integrojë lloje të ndryshme të të mësuarit, përfshirë edhe përdorimin e njohurive, zhvillimin e aftësive dhe shqyrtimin e ndryshimeve në sjellje. Gjatë trajnimit simulues, profesionistët mund të përvetësojnë njohuri në të gjitha këto nivele dhe trajnerët mund të arrijnë kështu qëllimet e shumëfishta në mënyrë sistematike. Pa një qasje të tillë sistematike, simulimi nuk e arrin dot qëllimin e të mësuarit e mund të shndërrohet në një eksperiencë kaotike. Simulimet vënë në praktikë parimet

e të mësuarit përmes përvojës. Kur simulimet përdoren për qëllime mësimi, duhet që të mbahet parasysh i gjithë cikli i të mësuarit dhe që trajnimi të hartohet duke u kushtuar vëmendje të gjitha fazave të procesit.

Metoda e të mësuarit përmes përvojës përfaqësohet nga një cikël me katër faza, ku pjesëmarrësit që trajnohen kalojnë nëpër këto hapa: përvojë, reflektim, përgjithësim dhe aplikim në kontekste reale² (përshkruar në figurën 1 më poshtë):

Figura 1:

Katër fazat e ciklit të të mësuarit eksperimental:



1 Përvoja. Në trajnimet simuluese të OSBE-së, në fillim të çdo dite trajnimi pjesëmarrsit angazhohen në zgjidhjen e rasteve të cilat bazohen në skenarë të paracaktuar. Ky lloj angazhimi kërkon një lloj reagimi nga ana e tyre.

Në këtë mënyrë aktivizohet mekanizmi i simulimit nga aktorët të cilët luajnë rolin e personazheve në rastet e dhëna nga trajnerët përmes emaileve, telefonatave, etj. Pjesëmarrësit në trajnim përballen me një sërë detyrash dhe situatash. Ata duhet të analizojnë situatën dhe të vendosin se çfarë të bëjnë dhe si ta kryejnë punën. Me shpalosjen e ngjarjeve, skuadrat e ndryshme duhet të ndër marrin hapa, të komunikojnë, të hetojnë dhe t'i përshtatin planet kur zbulohen elementë të rinj. Identifikohen viktimat, hetohen autorët e dyshuar, bëhen ndërhyrje në ndihmë dhe në mbrojtje të viktimave, etj. Kjo pjesë e procesit njihet si “përvoja” e trajnimit simulues.

2 Reflektimi. Duke qenë se trajnimet simuluese të OSBE-së i përfshijnë pjesëmarrësit në skenarë kompleksë, është e rëndësishme që pjesëmarrësit, së bashku me trajnerët që i drejtojnë ushtrimet, të kenë vazhdimisht mundësi për të reflektuar mbi atë çka ndodh gjatë eksperiencës së tyre. Fazat e reflektimit janë me

3 Reflektimi mund të ndodhë edhe gjatë kohës që pjesëmarrësit janë duke fituar eksperiencë. Megjithatë, në mënyrë që procesi i të mësuarit të jetë efektiv, është e rëndësishme që seancat pas trajnimit të zhvillohen sistematikisht dhe me pjesëmarrje.

rëndësi kyçe për përpunimin e informacionit, duke qenë se ato u japin mundësi trajnuesve dhe pjesëmarrësve në trajnim që të shkëmbejnë pikëpamje dhe të analizojnë atë çka ndodh. Pikërisht në këto shkëmbime fillon edhe procesi i të mësuarit.³

Reflektimet kryhen në fund të ditës në nivel skuadre dhe në nivel me të gjerë më të gjithë pjesëmarrësit. Seancat e reflektimit moderohen nga trajnerët.

3 Përgjithësimi. Pas analizimit të asaj se “çfarë ka ndodhur” gjatë eksperiencës përmes reflektimit, pjesëmarrësit në trajnim janë të gatshëm të shtjellojnë mësimet e përvetësuarat përmes përvojës dhe të nxjerrin përfundime. Kjo fazë i lejon pjesëmarrësit që të artikulojnë dhe të asimilojnë atë çka kanë mësuar.

4 Aplikimi. Faza përfundimtare e ciklit të të mësuarit hartohet në mënyrë të tillë që t'u japë mundësi pjesëmarrësve të diskutojnë lidhjet midis realitetit profesional dhe asaj çka përjetuan dhe mësuan nga ushtrimi, duke reflektuar mbi të dhe për mënyrat se si mund të përdoret ai në praktikë, si dhe mbi pengesat dhe mënyrat e kapërcimit të pengesave ekzistuese në jetën reale.



“Njësia e Policisë” gjatë trajnimit simulues.

Realizmi i simulimeve – Këtu vlen të theksohet se realizmi i simulimeve është një element i fuqishëm. Megjithatë, realizmi nuk është e vetmja karakteristikë kyçe e të mësuarit në ushtrimet simuluese. Është e rëndësishme që trajnuesit të mos mbështeten më shumë se duhet tek ky element në dëm të hapave të tjerë metodologjikë që lehtësojnë procesin e të mësuarit. Ndonëse elementët e realizmit që integrohen në simulime luajnë rol kyç për angazhimin dhe motivimin e pjesëmarrësve dhe mund ta bëjnë eksperiencën shumë të gjallë, procesi i të mësuarit varet nga shkalla e efikasitetit të të gjitha fazave të të mësuarit, përfshirë këtu reflektimin, përgjithësimin dhe aplikimin në trajnimin simulues.

PJESA II HARTIMI I TRAJNIMI SIMULUES

Komponentët e ushtrimeve simuluese

Komponentët e ushtrimeve simuluese janë:

- (A) pjesëmarrësit - pjesëmarrësit që trajnohen, trajnerët, aktorët dhe personeli mbështetës;
- (B) skenari— profili i vendit dhe personazheve, si dhe i skenarit të historisë së rastit;
- (C) matrica - një dokument bazë, ku përfshihen të gjitha veprimet, aktivitetet, objektivat dhe materialet; dhe
- (D) materialet fizike dhe vendet ku zhvillohen ushtrimet. Secili element përshkruhet me hollësi më poshtë.

A Pjesëmarrësit

Simulimet janë një metodë trajnimi, ku secili kontribuon për funksionimin e suksesshëm të ushtrimit të simulimit. Kështu, termi “pjesëmarrës” përfshin të gjithë personat që marrin pjesë në simulim—jo vetëm personat që trajnohen, siç ndodh në trajnimet më tradicionale. Pjesëmarrësit ndahen në katër kategori në bazë të funksionit të tyre në kuadrin e ushtrimit simulues:

1. **Personat që trajnohen**—profesionistët që trajnohen në simulim.
Gjatë simulimit, personat që trajnohen organizohen në

skudra sipas profesioneve të tyre reale (inspektorë pune, oficerë policie, prokurorë, punonjës socialë, etj.).

2. **Trajnerët** - ekspertë anti - trafikim të fushave të ndryshme që zhvillojnë dhe hartojnë përmbajtjen e simulimit, përfshirë edhe elementet e skenarit (p.sh. historia, skenari, etj.). Ata, gjithashtu, e drejtojnë vetë simulimin në disa cilësi:
 - a. “EXCON” është drejtuesi i grupit të HICON-eve, si dhe i të gjithë ushtrimit simulues në përgjithësi.
 - b. “HICON” (Kontrolli i Lartë) është një ekspert që gjatë simulimit është përgjegjës për një element të caktuar të trajnimit që është brenda fushës së

tij/ saj të kompetencës, si për zbatimin e ligjit, ndjekjen penale, inspektimin e punës, etj. Psh eksperti/trajneri që drejton punën e policisë njihet quhet “HICON Policia”.

- c. “DIREX” (Drejtim i Ushtrimit) është skudra që përbëhet nga HICON-ët dhe EXCON, të cilët menaxhojnë së bashku zhvillimin e ushtrimit.
- d. “Antenat” janë ekspertë anti-trafikim që mbështesin HICON-ët përmes monitorimit dhe raportimit të veprimtarive ndërsa ato zhvillohen gjatë ushtrimit. Ata janë sytë dhe veshët e DIREX dhe zgjidhen sipas fushave që lidhen me trajnimin në mënyrë që të kenë ekspertizë në secilën

fushë. Antenat raportojnë tek DIREX gjatë gjithë zhvillimit të ushtrimit si dhe marrin pjesë aktive gjatë seancave të reflektimit.

e. Aktorët—personat që luajnë rolet sipas “historive” apo skenarëve të zhvilluara paraprakisht. Aktorët trajnohen përpara zhvillimit të trajnimit.

f. Staf tjetër mbështetës—profesionistë që kryejnë funksione të ndryshme gjatë trajnimit (si përkthyesit, shoferët, personeli i logjistikës dhe sigurisë, asistentët teknikë, etj.).

Më poshtë jepen edhe disa hollësi të tjera për secilin nga pjesëmarrësit.

1. PERSONAT QË TRAJNOHEN

Një nga qëllimet kryesore të këtij mjedisi specifik të mësuarit është nxitja e punës bashkëpunuese mes shumë strukturave dhe profesionistëve të ndryshëm në fushën e antitrafikimit. Kështu, pjesëmarrësit që trajnohen kanë formime të ndryshme. Ata janë profesionistë realë nga disiplina të ndryshme në fokus të simulimit. Në jetën e tyre të përditshme janë të angazhuar në pozicione pune që lidhen drejtpërdrejt me anti-trafikimin. Sugjerohet që të jenë anëtarë apo përfaqësues të institucioneve të Mekanizmit Kombëtar të Referimit. Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të jenë të interesuar të marrin pjesë në një trajnim simulues për të thelluar njohuritë dhe aftësitë përmes një eksperience të re të të mësuarit. Për këtë arsye, pjesëmarrësit duhet të përzgjidhen sipas fushës së tyre të përvojës dhe të grupohen në skuadra sipas disiplinave në jetën reale.



“Njësia e Prokurorisë” gjatë trajnimit simulues.

Disiplinat e synuara nga simulimi duhet të pasqyrojnë situatat më shqetësuese dhe tipike të trafikimit në vend. Në trajnimin simulues në Shqipëri pjesëmarrësit ishin:

- Prokurorë
- Oficerë të policisë: 1. Seksioni kundër trafikëve të paligjshme; 2. Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit; 3. Sektori i të miturve dhe Dhunës në Familje; 4. Krimi ekonomik dhe financiar.
- Inspektorë pune
- Ofrues shërbimesh në ndihmë të viktimave (përfshirë edhe punonjës të OJFve dhe të Shërbimi Social Shtetëror)

- Punonjës të Seksionit të Mbrojtjes së Fëmijës Pjesëmarrësit ndahen në skuadra të cilat marrin dhe emërtimet përkatëse dhe kanë këto role:

PROKURORIA

Prokuroria drejton dhe koordinon hetimet e organizatave kriminale që merren me trafikimin e qenieve njerëzore. Prokurorët e mbështesin punën e tyre të marrja e provave dhe informacioneve, duke pasur si qëllim përfundimtar ngritjen e akuzave ndaj autorëve. Skuadra e Prokurorisë është përgjegjëse për përgatitjen e kërkesave për autorizimin e kryerjes së veprimeve hetimore, si dhe për

mbledhjen e provave për t'i nxjerrë autorët para gjykatës.

Prokurorët mësojnë se si të nxisin bashkëpunimin mes strukturave të shumta të përfshira në këtë proces, si dhe se si t'i angazhojnë ato në hetime proaktive me në qendër viktimën. Prokurorëve u duhet që të planifikojnë dhe të zhvillojnë aktivitete ku përfshihet edhe bashkëpunimi ndërkombëtar. Prandaj, nevojitet jo vetëm njohja e kuadrit ligjor përkatës, por edhe e instrumenteve kryesore ndërkombëtare.

Duke pasur parasysh natyrën komplekse të hetimeve që kërkohen gjatë një simulimi, prokurorët që marrin pjesë në të duhet të kenë përvojë me menaxhimin dhe koordinimin e hetimeve në fushën e krimit të organizuar, sidomos në hetimet që fokusohen te trafikimi i qenieve njerëzore. Një veçanti e trajnimit simulues në Shqipëri ishte përfshirja e studentëve të Shkollës së Magjistraturës që punuar përkrah prokurorëve me përvojë për ndjekjen penale të rasteve.



“Njësia e Policisë” gjatë trajnimit simulues.

NJËSIA E POLICISË (NJP)

Ushtrimet simuluese ia besojnë barrën kryesore të veprimeve hetimore Njesisë së Policisë (NJP). Në këtë cilësi, gjatë simulimit, pjesëmarrësit që trajnohen, planifikojnë, zhvillojnë dhe koordinojnë hetimet komplekse të organizatave kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore. Përgjegjësia e NJP-së është që të kryejë hetime me të gjitha teknikat dhe metodat e duhura për rindërtimin e skenës së krimit dhe për të mbledhur prova për ndjekjen penale. Me identifikimin e viktimave, NJP duhet të marrë masat që ato të ndihmohen dhe të mbrohen duke aktivizuar

shërbimet e nevojshme mbështetëse. Gjithashtu, NJP duhet të kërkojë dhe të mbledhë prova për identifikimin e autorëve. Oficerët e NJP-së duhet të jenë të vetëdijshëm se mund të përballen me të dyshuar që janë në të vërtetë viktimë ose me viktimë që janë në procesin e të shndërruarit në autorë krimi, kështu që do të duhet të gjejnë mënyrën e duhur për t'u marrë edhe me këto raste.

Sipas organizmit strukturor të policisë Shqiptare, oficerët e Seksionit kundër Trafikeve të Paligjshme angazhohen në hetimin e autorëve, intervistimin e viktimave të mundshme dhe bashkërendojnë veprimet

me ofruesit e shërbimeve sociale me qëllim garantimin e identifikimit, referimit dhe mbrojtjes së viktimave. Në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit, oficerët e trafiqueve të paligjshme mund të marrin referim nga struktura të tjera të policisë. Në këtë rast është e nevojshme që në trajnim të përfshihen dhe oficerë të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për rastet e shtetasve të huaj të identifikuar në kufi ose në territor, si dhe oficerë të të miturve për rastet e fëmijëve.

Format e shfrytëzimit të integruara në këto raste hipotetike dhe që dalin në pah në këtë ushtrim varen nga prioritetet që ka një ushtrim specifik trajnimi, si për shembull format mbizotëruese të trafikimit në një kontekst të caktuar. Prandaj, strategjitë e hetimit dhe protokollët e referimit që përdoren nga NJP duhet t'i përshtaten natyrës së rastit.

Oficerët e policisë që përzgjidhen për NJP-së duhet të zotërojnë aftësi shumë të mira hetimi, përfshirë edhe aftësitë për të mbledhur informacion inteligjence dhe të dhëna. Përveç kësaj, duke pasur parasysh objektivat e trajnimit simulues dhe karakteristikat dalluese të trafikimit të qenieve njerëzore, ata duhet të kenë edhe përvojë dhe njohje të bashkëpunimit policor ndërkombëtar.

NJËSIA E HETIMIT FINANCIAR (NJHF)

Trafikimi i qenieve njerëzore është një krim që gjeneron fitime kolosale. Hetimet financiare përbëjnë një aspekt të rëndësishëm—gjithsesi të pashfrytëzuar sa duhet— të luftës kundër trafikimit, duke qenë se ndjekja e lëvizjeve të parasë është e dobishme për shpërbërjen e rrjeteve të trafikantëve, duke hetuar lidhjet e mundshme me rrjetet e tjera të krimit të organizuar (p.sh. rrjetet e terrorizimit, kontrabandimit të emigrantëve ose trafikimit të drogës), si dhe duke siguruar kompensim për viktimat.

Ushtrimet simuluese duhet të parashikojnë përfshirjen e një Njësie të Hetimit Financiar (NJHF) që bashkëpunon me një prokurorësh dhe oficerësh policie të specializuar për trafikimin. Roli i NJHF-së është që të ofrojë mbështetje

të specializuar, orientime dhe këshillime për kryerjen e hetimeve financiare të nevojshme për gjurmimin e krimit. NJHF duhet të trajnohet për të kryer hetimet financiare të krimit të organizuar transnacional që merret si rast në ushtrimin simulues për trafikimin e qenieve njerëzore. Duke pasur parasysh kompleksitetin dhe natyrën specifike të hetimeve financiare, anëtarët e NJHF-së që trajnohen duhet të kenë përvojë të mjaftueshme me hetimet penale ndërkombëtare komplekse në fushën e krimeve financiare dhe pastrimit të parave. Në trajnimin simulues në Shqipëri, hetimi financiar u hartua nga drejtues të lartë të Drejtorisë së Krimit Ekonomik dhe Financiar në policinë e shtetit dhe u përfshi në skenarë duke mundësuar zbulimin e veprës penale nëpërmjet metodave të hetimit financiar dhe pasuror.



“Njësia e Hetimit Financiar” gjatë trajnimit simulues.

NJËSIA E INSPEKTORIATIT TË PUNËS (NJIP)

Shfrytëzimi për punë është një nga format më të përhapura të trafikimit të qenieve njerëzore. Nëse një prej historive imagjinare që përdoret për simulim ka të bëjë me një rast të shfrytëzimit për punë, në ushtrim duhet të përfshihet edhe një NJIP.

Inspektorët e punës, në bashkëpunim të ngushtë me policinë mësojnë se si të punojnë në një kontekst ku përfshihen disa struktura njëherësh dhe kryejnë inspektime biznesesh që lidhen me organizatat kriminale të përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore.

NJIP duhet të përfshihet edhe në të gjitha aktivitetet që kërkojnë njohuri të specializuara për shfrytëzimin e punës dhe për shkeljen e ligjeve të punës. Në kontekstin shqiptar, ku inspektorët e punës nuk kanë funksione policore, është e rëndësishme që NJIP të bashkëpunojë me Njësinë e Policisë dhe në rastin e viktimave të huaja dhe me oficerët e Kufirit dhe Migracionit.

AUTORITETI I AZILIT

Punonjësit e autoritetit të azilit, në kryerjen e intervistimeve të azilkërkuesve, mund të dallojnë ndonjëherë “tregues trafikimi”. Në këto raste, personat përkatës duhet të referohen tek shërbimet e specializuara për të marrë mbrojtje dhe ndihmë të mjaftueshme. Kur bashkëpunohet me profesionistë të tjerë në ushtrimet simuluese, qëllimi i punonjësve të autoritetit të azilit është shkëmbimi i informacioneve, duke mbrojtur në të njëjtën kohë konfidencialitetin. Duke integruar shërbimet plotësuese mbrojtëse, të cilat janë gjithsesi të ndryshme,

autoriteti i azilit duhet të marrë hapa për të kontribuar në adresimin e hendeqeve mes sistemit të dhënies së azilit dhe sistemit të luftës kundër trafikimit.

Për këtë rol, nevojitet përvojë e mëparshme pune si anëtar i një autoriteti ndërkombëtar për mbrojtjen dhe për përcaktimin e statusit, si dhe njohuri rreth trafikimit të qenieve njerëzore. Avantazh përbën edhe njohja e ligjeve përkatëse ndërkombëtare për refugjatët, përvoja e punës në kontekste prej shumë agjencish, si dhe përvoja në zhvillimin e intervistave me aplikantët.



“Njësia e Inspektoratit të Punës” diskuton me “Njësinë e Policisë” bashkëpunimin për rastet e shfrytëzimit në punë.

OFRUESIT E SHËRBIMEVE TË ASISTENCËS NDAJ VIKTIMAVE

Profesionistët që u ofrojnë ndihmë viktimave mund të përfshijnë si përfaqësues të institucioneve shtetërore, ashtu edhe ata joshtetërorë. Në këtë grup përfshihen veçanërisht punonjësit e shërbimit social shtetëror, punonjësit socialë në nivel bashkie, punonjësit e mbrojtjes së fëmijës, të strehëzave anti-trafiking apo dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile që ofrojnë shërbime të ndryshme në asistencë të viktimave të trafikimit. pavarësisht se shërbimet ofrohen kryesoshit nga organizatat e shoqërisë civile, nuk duhet harruar se garantimi i mbrojtjes, aksesit në drejtësi, si dhe kompensimi për viktimat është detyrë e institucioneve të drejtësisë dhe për këtë arsye, bashkëpunimi midis të gjithë sektorëve është shumë i rëndësishëm kur synohet një qasje që ka në qendër viktimën.

Objektivi kryesor i të mësuarit sa u përket ofruesve të shërbimeve në ndihmë të viktimave gjatë këtyre ushtrimeve simuluese është rritja e përpjekjeve për identifikimin e viktimave, si dhe pajisja e tyre me mbështetje dhe asistencë sa i përket kujdesit shëndetësor, mbështetjes psikologjike, përfshirjes sociale, si dhe aksesit në programe riintegruese ose programe për një kthim të sigurt.



Ofruesit e shërbimeve të asistencës ndaj viktimave të trafikimit.



Ofruesit e shërbimeve të asistencës ndaj viktimave të trafikimit.

Këto janë përgjegjësi komplekse që kërkojnë kryerjen e detyrave të shumta në faza të ndryshme të simulimit. Gjatë ushtrimeve simuluese, profesionistët e OJQ-ve dhe/ose të ofruesve qeveritarë të shërbimeve, si punonjësit e shërbimeve sociale në nivel lokal, përballen me vështirësi në ofrimin e ndihmës dhe mbështetjes si viktimave të prezumuara, ashtu edhe atyre të identifikuar.

Hetimet çojnë në arrestimin e trafikantëve gjatë këtij ushtrimi dhe të viktimave sipas mandatit specifik të konteksteve të vendeve të ndryshme.

Ajo çka kërkohet është përvoja e punës drejtpërdrejt me viktimat e trafikimit në faza të ndryshme – që nga identifikimi i viktimave të mundshme deri tek identifikimi

formal. Këtu mund të përfshihet edhe mbështetja psikologjike dhe ligjore, programet e përfshirjes sociale, shërbimet e këshillimit ligjor, etj.

Duke marrë parasysh detyrat e shumta që përfshin ndihma për viktimat, në këtë ekip duhet të përfshihen jo vetëm ofrues që ofrojnë ndihmë të përgjithshme dhe shërbime të përfshirjes sociale, por edhe profesionistë me kompetenca të specializuara (ndihmë psikologjike, këshillim ligjor, etj.).



AVOKATËT E SPECIALIZUAR

Duke punuar në bashkëpunim të ngushtë me profesionistët e ofrimit të shërbimeve në ndihmë të viktimave, një skuadër avokatësh të specializuar mësojnë të ofrojnë këshillim ligjor dhe asistencë – në një kontekst prej shumë agjencish për viktimat të prezumuara dhe të identifikuar të trafikimit për të përmbushur detyrimet ligjore për mbrojtjen dhe vënien në vend të të drejtave të tyre.



Pjesëmarrës nga Prokuroritë e rretheve dhe studentë magistratë ishin pjesë e “Njësisë së Prokurorisë”.

Këta avokatë, qofshin avokatë që punojnë për studio ligjore private apo si pjesë e OJQ-ve, duhet të kenë njohuri për legjislacionin e antitrafikimit dhe të drejtave të njeriut, rregulloret e azilit dhe migracionit, instrumentet ligjore, si dhe për ligjet përkatëse administrative.

3 Thirrja për pjesëmarrës në trajnimin simulues të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, i zhvilluar në tetor 2021: <https://www.osce.org/sq/presence-in-albania/493552>

Në simulimin shqiptar, u përfshinë avokatë të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas duke nxitur kështu përfshirjen e tyre aktive për këshillimin dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit.

PJESËMARRËSIT E TJERË NË TRAJNIM

Skuadrat e përshkruara më lart janë agjencitë kryesore që përfshihen në reagimet kundër trafikimit. Megjithatë, ato nuk përfaqësojnë të gjithë aktorët e mundshëm, agjencitë apo profesionistët që mund të përfshihen në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore. Në varësi të kontekstit, mund të shihet edhe mundësia e përfshirjes

së skuadrave apo pjesëmarrësve të tjerë me formime të ndryshme profesionale në hartimin e simulimeve specifike. Zakonisht, simulimet e OSBE-së kanë përfshirë edhe pjesëmarrës nga fusha e medias. Gazetarëve u është kërkuar të raportojnë për ngjarje që shpalosen gjatë simulimit dhe të përgatisin materiale dhe artikuj për median lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore në bazë të atyre rasteve. Roli i gazetarëve është i rëndësishëm për të garantuar raportim të drejtë, ndërgjegjësim të përgjithshëm dhe një qasje me në qendër viktimën.

PËRZGJEDHJA E PJESËMARRËSVE NË TRAJNIM

Për të përzgjedhur një grup aplikantësh të ndryshëm dhe tejet të kualifikuar, është shumë e rëndësishme që thirrja për aplikime në këto ushtrime të shpërndahet gjerësisht³. Në simulimin shqiptar pjesëmarrësit e shoqërisë civile u përzgjedhën nëpërmjet thirrjes së hapur ndërsa pjesëmarrësit nga strukturat shtetërore nëpërmjet komunikimit me institucionet përkatëse. Numri i pjesëmarrësve që marrin pjesë në kurset e trajnimit me simulim varet nga buxheti dhe qëllimet e ushtrimit. Organizatorët duhet të përpiqen të garantojnë një baraspeshë mes strukturave anti-trafikim, gjinive dhe disiplinave profesionale. Trajnimet me simulim që përshkruhen në këtë udhëzues kanë për qëllim trajnimin e profesionistëve që kanë tashmë përvojë praktike në punën kundër trafikimit.

Përveç kësaj, objektivat e të mësuarit kanë si qëllim kryesisht personat që kryejnë këtë punë aktualisht në terren.

Qëllimi i trajnimeve simuluese të OSBE-së është jo vetëm rritja e ndërgjegjësimit dhe ofrimi i njohurive bazë; por përmirësimi i infrastrukturës ekzistuese kundër trafikimit duke u mësuar profesionistëve se si t'i përdorin njohuritë dhe aftësitë e tyre aktuale në mënyrë më efektive përmes bashkëpunimit mes shumë agjencive dhe një qasjeje të koordinuar dhe të bazuar tek të drejtat e njeriut.

Në këtë mënyrë, përzgjedhja e personave që trajnohen duhet të jetë e ekuilibruar, duke marrë parasysh përvojën dhe nevojën për trajnime të mëtejshme dhe të avancuara.

Grupi kryesor i ekspertëve ngarkohet fillimisht me hartimin e skenarëve të rasteve dhe me krijimin e një vendi apo rajoni imagjinar ku do të zhvillohet simulimi. Kjo fazë kërkon diskutime metodike dhe aftësi analitike. Më pas, i njëjti ekip ekspertësh menaxhon dhe angazhohet me persona që trajnohen, duke ekzekutuar ushtrimet e simulimit.

Secili ekspert është përgjegjës për një komponent të trajnimit, që është në fushën e tyre të kompetencës, si p.sh. komponentë që lidhen me zbatimin e ligjit, ndjekjen penale, inspektimin e punës, etj.

Siç theksohet më sipër, këta ekspertë quhen “HICON-ë”. HICON-ët janë përgjegjës për monitorimin dhe orientimin e aktiviteteve të grupeve të tyre përkatëse të pjesëmarrësve gjatë ushtrimeve reale, për informimin e pjesëmarrësve pas trajnimit çdo ditë, si dhe për ruajtjen e fokusit të grupit tek objektivat e tyre.

Duke qenë se atyre u kërkohet të luajnë një sërë rolesh të ndryshme, kriteret për përzgjedhjen e ekspertëve kryesorë duhet të përfshijnë përvojën e mëparshme me bashkëpunimin mes agjencive të shumta, aftësitë trajnuese/moderuese, si dhe përvojën me ushtrime që konsistojnë në lojën me role. Zakonisht, ushtrimet simuluese të OSBE-së përfshijnë këto grupe HICON, të cilët, të gjithë se bashku formojnë DIREX:

- Prokurorinë (NJP)
- Njësinë e Policisë (NJP)
- Njësinë e Hetimeve Financiare (NJHF)
- Njësinë e Inspektimit të Punës (NJIP)
- Njësinë për Ndihmën dhe Mbrojtjen e Viktimave (NJNMV)
- Avokatët
- Autoritetet e azilit ose migracionit



Antenat duke ndjekur veprimet në terren gjatë ushtrimit simulues.

ANTENAT janë “sytë dhe veshët” e HICON-eve. Këta janë personat që i ndjekin veprimet në terren gjatë ushtrimeve simuluese, monitorojnë në heshtje aktivitetet e pjesëmarrësve (pa ndërhyrë drejtpërdrejt në veprimet e pjesëmarrësve), si dhe raportojnë tek HICON-ët për progresin e arritur nga secili ekip. Për shkak të natyrës së ndryshueshme të ushtrimeve, nevojitet që komunikimi mes antenave dhe HICON-eve të zhvillohet në kohë reale, si p.sh. përmes mesazheve telefonike, ose me email. Marrja e informacioneve të vazhdueshme u jep mundësi HICON-eve që të mund të bëjnë ndryshime apo shtesa në ushtrimet simuluese në përfitim të trajnimit të përgjithshëm.

Antenat përfshihen në kategorinë e ekspertëve, sepse ato duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për trafikimin



Trajnimi i Antenave gjatë javës përgatitore.

e qenieve njerëzore që të jenë në gjendje të vlerësojnë veprimet e anëtarëve të ekipeve dhe t'u japin raporte thelbësore HICON-ëve. Për të pasur raportime të sakta dhe këshillime në kohë reale për HICON-ët, është gjithashtu e rëndësishme që të përzgjidhen antena që kanë përvojë në disiplinat specifike që u caktohen (p.sh. prokurori, zbatim ligji, mbrojtje sociale, inspektim pune, inspektime financiare, etj.).

TRAJNUESIT

Për të hartuar dhe për të realizuar një kurs trajnimi me bazë simulimin, duhet të rekrutohet dhe të mblidhet një ekip multidisiplinare trajnuesish. Trajnuesit kanë dy funksione kryesore: (1) hartimin e ushtrimeve, si dhe (2) mbikëqyrjen e ushtrimeve. Hartimi i ushtrimeve përfshin

hartimin e skenarit dhe të matricës (përshkruar në mënyrë më të hollësishme më poshtë). Për të garantuar njohje të thelluar të përmbajtjes së ushtrimeve gjatë ekzekutimit të tyre, është mirë që zbatimi i tyre të mbikëqyret nga personat që kanë hartuar programin.

Trajnuesit duhet të jenë ekspertë në fushën përkatëse dhe të kenë disa vite përvojë në punën kundër trafikimit. Në hartimin e ushtrimit të saj të parë, OSBE-ja përzgjedh një ekip ekspertësh që përbëhet nga profesionistë me përvojë në zbatimin e ligjit, prokurorë, oficerë policie, inspektorë të punës, ofrues shërbimesh ndihmëse për viktimat me njohje dhe përvojë në rastet e trafikimit të qenieve njerëzore.



Antenat duke ndjekur veprimet në terren gjatë ushtrimit simulues.



Trajnimi i Aktorëve gjatë javës përgatitore.

Rekrutimi i një grupi të kualifikuar aktorësh për simulim është një hap i rëndësishëm. Në realizimin e disa simulimeve, OSBE-ja ka pasur si partnerë universitetet lokale. Studentët e juridikut dhe të të drejtave të njeriut, si dhe studentët e dramaturgjisë janë përzgjedhur dhe janë trajnuar për të marrë pjesë në këto ushtrime. Në raste të tjera, në ushtrime janë përfshirë si aktorë disa punonjës socialë me përvojë. Në rastin e simulimit shqiptar u ndoq e njëjta metodologji dhe grupi i aktorëve u përgatit nga një regjizor dhe grupi kryesor i trajnerëve, duke i njohur hollësisht aktorët me metodologjinë e trajnimit dhe fenomenin e trafikimit në kontekstin shqiptar. Në javët para zhvillimit real të ushtrimeve, rekomandohet që aktorëve të tillë joprofesionistë t'u jepet një kurs bazë aktrimi, si dhe një kurs për t'i njohur ata me trafikimin e

AKTORËT

Aktorët e trajnuar janë shumë të rëndësishëm për suksesin e ushtrimeve të simulimit. Ata u japin jetë historive. Aktorët kryejnë një sërë rolesh, përfshirë rolin e viktimës, autorëve të trafikimit, si dhe të oficerëve të policisë lokale. Çdo personazh ka një rol të caktuar në histori. Përgatitja e aktorëve për portretizimin e simulimit dhe angazhimi me pjesëmarrësit është shumë i rëndësishëm, duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e simulimit mbështetet tek veprimet e tyre. Për shkak të rolit të tyre të rëndësishëm, aktorët duhet të përgatiten për simulim nga një profesionist dhe nën mbikëqyrjen e një trajnuesi.



Trajnimi i Aktorëve gjatë javës përgatitore.

qenieve njerëzore për të garantuar përgatitjen e tyre si duhet.

Çështja e gjuhës – Për hir të realizmit, personat që luajnë rolin e viktimave të huaja dhe trafikantëve të huaj në simulim duhet të flasin një gjuhë të ndryshme nga ajo që flasin pjesëmarrësit në trajnim.

PUNONJËSIT E TJERË MBËSHTETËS

Punonjësit e tjerë mbështetës – si përkthyesit, shoferët, personeli i logjistikës dhe asistentët teknikë – janë pjesë përbërëse e simulimeve të tilla. Përfshirja e tyre nuk duhet të harrohet gjatë planifikimit të simulimit.

Në bazë të përvojës së OSBE-së, në organizimin e trajnimeve simuluese një javore me pjesëmarrjen e 50-70 personave, rekomandohet që të ngrihet një ekip i përbërë prej të paktën:

- **Një menaxher/koordinatar projekti:** përgjegjës për koordinimin dhe organizimin dhe zbatimin e simulimit, monitorimin dhe vlerësimin e trajnimit, si dhe për menaxhimin e kontakteve me partnerët e jashtëm, duke përfshirë edhe institucionet ndërkombëtare;
- **Një asistent projekti** (që punon ngushtësisht me menaxherin e projektit): përgjegjës për ofrimin e mbështetjes administrative dhe koordinimin në organizimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e trajnimit;

- **Personel** për shërbimet e administratës dhe shërbimeve financiare;
- **Eksptë për Teknologjinë e Informacionit** dhe Komunikimit (TIK): trajnimet simuluese kërkojnë një rrjet kompjuterësh, internet dhe servera për intranet, printera, etj. Prandaj, është e rëndësishme që të mendohet paraprakisht edhe për infrastrukturën e nevojshme për TIK dhe për të pasur një pikë fokale për shërbimet TIK gjatë fazave të planifikimit dhe ekzekutimit;
- **Shërbimet e transportit dhe shoferët:** janë të nevojshëm në rast se simulimi parashikon edhe transportimin e pjesëmarrësve në vende jashtë

qendrës ku zhvillohet trajnimi (p.sh. në vende imagjinare ku mendohet se shfrytëzohen viktimat); për këtë komponent nevojitet mbështetje logjistike dhe planifikim i hollësishëm.

- **Mbështetja e rendit publik dhe sigurisë:** në rast se veprimet duhet të kryhen nga pjesëmarrësit jashtë qendrës së trajnimit (p.sh. kryerja e një kontrolli të një fabrike apo shtëpie publike imagjinare), policia lokale duhet të përfshihet për të garantuar rendin publik dhe për të informuar publikun rreth ushtrimit sipas nevojës (p.sh. simulimi i një kontrolli të një apartamenti duhet t'u shpjegohet civilëve që mund të jenë duke e parë).



Antarët e DIREX dhe Vëzhguesit e trajnimit të asistuar nga përkthyes.

B SKENARI

“Skenari” është një histori imagjinare brenda së cilës shpaloset ushtrimi i simuluar. Për të pasur një ndjesi optimale realizmi dhe për të përmbushur qëllimet e një ushtrimi multidisiplinar, hartimi i skenarit kërkon vizion strategjik dhe vëmendje ndaj detajeve. Skenari përbëhet nga katër pjesë kryesore – profilet e vendeve të përfshira, kuadri ligjor, historia e rastit, si dhe profilet e personazheve. Profilet e vendeve të përfshira në rastin përkatës duhet të japin disa tregues dhe informacione që i ndihmojnë pjesëmarrësit të kuptojnë rastin, si të dhëna në lidhje me formimin apo kulturën e viktimës.

Për të përshkruar kontekstin brenda të cilit zhvillohet historia, është e rëndësishme që të jepen faktorët e detajuar gjeografikë, historikë dhe socialë-ekonomikë të vendeve në fjalë. Në ushtrimin simulues shqiptar, profili kryesor ishte i Shqipërisë por dhe i vendeve të origjinës të viktimave të huaja të shfrytëzuara në Shqipëri dhe i vendeve të destinacionit të viktimave shqiptare. Profilet

e vendeve iu përshtaten kontekstit shqiptar dhe formave më të përhapura të trafikimit të qenieve njerëzore, sipas raporteve vendase dhe ndërkombëtare për situatën në Shqipëri. Si rregull, rekomandohet që emrat e vendeve (dhe emra të tjerë gjeografikë, si p.sh. emrat e kryeqyteteve) që portretizohen në skenar, të jenë emra imagjinarë.

Profilet e vendeve duhet t’u jepen pjesëmarrësve paraprakisht në mënyrë që ata të familjarizohen me botën imagjinare ku do të operojnë. Ato duhet të shihen gjithashtu edhe nga pjesëmarrësit para se të fillojë simulimi. Për t’u siguruar që secili ekip është i njohur me këto specifikime, para se të fillojë simulimi pjesëmarrësve duhet t’u jepet kohë e mjaftueshme për t’u njohur me kontekstin.

PROFILET E VENDEVE

Profilet e vendeve japin kontekstin dhe kuadrin e përgjithshëm të zonave gjeografike imagjinare ku zhvillohet simulimi. Profili mund të përfshijë:

- Vendet e origjinës së personazheve kryesore (si të viktimave, ashtu edhe të autorëve);
- Vendet ku kanë udhëtuar personazhet, ose vendet ku ata jetojnë dhe operojnë gjatë kohës që kryhet hetimi;
- Vendi ku janë identifikuar viktimat dhe ku kryhet hetimi;
- Vendet ku nxirren të ardhura të paligjshme dhe ku pastrohen paratë, vende që mund të jenë ose jo

të gatshme për të bashkëpunuar nga pikëpamja gjyqësore dhe hetimore.

Është e rëndësishme që në këto profile të jepen informacione të hollësishme mbi kontekstin:

- Konteksti social-politik i vendeve të përfshira;
- Marrëdhënia e tyre juridike me vende të tjera (p.sh. ekzistenca e marrëveshjeve ose jo mes këtyre vendeve);
- Informacione në lidhje me tendencat e trafikimit të qenieve njerëzore në secilin vend ose rajon;
- Një hartë ku ilustrohen karakteristikat kryesore të skenarit (p.sh. kufijtë detarë dhe tokësorë, malet, etj.).

KUADRI LIGJOR

Ushtrimet e simulimit kërkojnë një kuadër ligjor për kontekstin imagjinar të simulimit. Veçanërisht në rastin e ushtrimeve që përfshijnë disa vende njëherësh, të pasurit e një kuadri ligjor imagjinar uniformë bën që të gjithë pjesëmarrësit të luajnë në të njëjtën fushë loje, d.m.th. që të gjithë të ndjekin të njëjtat rregulla. Ky kuadër duhet të përfshijë procedurat standarde të operimit (PSV) për trajtimin e rasteve të trafikimit, si dhe ligjet përkatëse.

[Në simulimin shqiptar është reflektuar tërësisht legjislacioni shqiptar penal dhe i fushave të tjera në lidhje me trafikimi](#)

ne qenieve njerëzore. Aktet ligjore dhe nënligjore u reflektuan në skenarë dhe në procedura dhe iu vunë në dispozicion pjesëmarrësve në trajnim. PSV-të ndihmuan pjesëmarrësit të ndjekin të njëjtat procedura në menaxhimin e rasteve të trafikimit të qenieve njerëzore.

Pjesëmarrësit patën mundëis të zbatojnë PSVtë dhe njëkohësisht të reflektonin mbi çështje që kanë nevojë për përmirësimin për të siguruar një qasje të orientuar drejt mbrojtjes së viktimës së trafikimit.

MEKANIZMI KOMBËTAR I REFERIMIT

Marrëveshja e bashkëpunimit për “Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit” rregullon funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe ndihmën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit.

Palë në marrëveshje janë:

- Ministria e Brendshme
- Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
- Ministria e Arsimit dhe Rinisë,
- Ministria e Shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale
- Prokuroria e Përgjithshme
- Organizata Ndërkombëtare për Migracionin



Aktorët në rolet e viktimave të trafikimit.

- Organizata Ndërkombëtare “World Vision”-Tiranë
- Organizata jofitimprurëse “Arsis”
- Organizata jofitimprurëse “Të ndryshëm dhe të barabartë”-Tiranë
- Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit -Tiranë
- Organizata Jofitimprurëse Qendra Psiko Sociale “Vatra” Vlorë
- Organizata jofitimprurëse “Tjetër Vizion”-Elbasan

Qëllimi kryesor i kësaj marrëveshje është sigurimi i zbatimit të procedurave standard të Veprimit për identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit si dhe përfundimi i partneritetit të aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë në funksion të mbështetjes së viktimave që prej identifikimit e deri në riintegrimin e plotë të tyre. Çdo palë në marrëveshje merr angazhimet sipas fushës së përgjegjësisë në funksion të identifikimit dhe mbrojtjes së viktimave e viktimave të mundshme të trafikimit.

HISTORIA E TRAFIKIMIT

Historia është “skenari” i një simulimi. E hartuar nga trajnuesit bazuar në raste të ndryshme të trafikimit të qenieve njerëzore, këto histori kërkojnë një hartim të kujdesshëm dhe të koordinuar.

Historitë duhet t’u ofrojnë pjesëmarrësve një pistë hetimi nga fillimi deri në fund, d.m.th. gjithë procesin deri në ndjekjen penale. Duke qenë se simulimet e OSBE-së ndalojnë në fazën para gjyqimit të çështjes në gjykatë, materialet e ofruara në këtë udhëzues nuk mbulojnë fazat e mëvonshme të ndjekjes penale apo të gjyqimit.

Historitë përfshijnë një sërë ngjarjesh, të quajtura “veprime” dhe “aktivitete”; për çdo veprim (të iniciuar përmes “injektimeve” nga trajnuesit apo nga një aktor që merr pjesë në simulim), parashikohet një aktivitet korrespondues (që ndërmerret nga pjesëmarrësit). Asnjë veprim nuk duhet të nxitet nga trajnuesit pa një qëllim specifik; veprimet janë projektuar nga trajnuesit për arritjen e objektivave specifike të të mësuarit ose për zhvillimin e aftësive specifike. Veprimet dhe aktivitetet duhet gjithashtu të marrin parasysh të gjithë ciklin e punës kundër trafikimit, që nga vendi dhe koha e identifikimit të një krimi deri tek arrestimi dhe ndjekja penale e autorëve.

Për më tepër, aty duhet të përfshihet edhe mënyra se si identifikohet, si ndihmohet dhe si mbrohet viktimat.

Disa shembuj veprimesh të nxitura nga trajnuesit mund të përfshijnë intervistimin e një viktime të prezumuar, kontrollin e një banese, koordinimin e një takimi mes agjencive të ndryshme ose prezantimin e një sërë aktivitetesh hetimi. Duke qenë se veprimet janë të ndryshme për nga natyra dhe qëllimi i tyre, ato mund të zgjasin me minuta ose me orë, sipas situatës. Veprimet mund të mbivendosen me njëri-tjetrin në kohë dhe në

hapësirë, duke çuar në një shkallë të lartë kompleksiteti me zhvillimin e historisë dhe duke kërkuar reagim nga ekipet e ndryshme. Ashtu sikurse në rastet reale në kontekstin e përfshirjes së shumë agjencive, në këto veprime mund të përfshihet një skuadër e vetme ose disa skuadra njëherësh nga agjenci të ndryshme bashkëpunuese.

Në simulime, aktivitetet që zgjasin me javë ose me muaj në realitet, duhet të zhvillohen brenda disa orëve ose disa ditëve. Kështu, ngjarjet dhe veprimet duhet të zgjidhen me kujdes, duke u kushtuar vëmendje kritereve thelbësore, dhe ajo çka është më e rëndësishmja, duke i kushtuar vëmendje objektivit të të mësuarit të ngjarjeve/veprimeve specifike dhe lidhjeve të tyre me objektiva të përgjithshme të trajnimit, si nxitja e reagimeve efikase multidisiplinare.

Asnjë element i skenarit nuk duhet t’u bëhet i ditur pjesëmarrësve, të cilëve do t’u kërkohej që ta rindërtojnë historinë e rastit dhe ta kuptojnë atë. Të gjithë personat e përfshirë në hartimin dhe zbatimin e skenarit duhet të informohen për këtë kriter që nga fillimi i përfshirjes së tyre në këtë projekt.

Sa histori duhet të paraqiten në një simulim?

Simulimi mund të bazohet në një rast apo hetim të vetëm imagjinar. Në raste të tjera, mund të kombinohen edhe më shumë se një histori për të formuar një ushtrim më kompleks. Në varësi të objektivave të trajnimit, në këto raste mund të përfshihen edhe krime të tjera për ta bërë edhe më kompleks trafikimin e qenieve njerëzore

(si p.sh. kontrabandimi i emigrantëve ose pastrimi i parave). Në ushtrimin e Shqipërisë u krijuan dy histori, d.m.th. dy raste hetimi, një rast të shfrytëzimit seksual dhe një të punës së detyruar. Këto simulime zhvillohen në një kontekst imagjinar që pjesëmarrësit mund ta kuptojnë, d.m.th. në një kontekst të ngjashëm apo të krahasueshëm me kontekstin real ku ata operojnë në punën e tyre të përditshme.

Sa veprime duhet të përfshihen në një skenar?

Numri i veprimeve të parashikuara në secilin skenar mund të variojë. Kjo duhet parë me kujdes. Është e rëndësishme që pjesëmarrësit të mos mbingarkohen me një numër të tepruar veprimesh.

Megjithatë, nëse gjatë ushtrimit nuk përfundohen të gjitha veprimet e planifikuara, procesi i të mësuarit me katër faza mund të ndodhë gjithsesi dhe mund të arrihen objektivat e të mësuarit.


Nga ana tjetër, kufizimi i numrit të veprimeve mund t'i ndihmojë pjesëmarrësit të fokusohen në disa aftësi specifike. Mundet që pjesëmarrësit të devijojnë nga skenari në një moment të caktuar gjatë ushtrimit. Kjo mund të ndodhë për arsye të ndryshme. Ata mund të ndjekin pistën e gabuar dhe të mos i përmbahen skenarit ose mes grupeve të ndryshme të pjesëmarrësve mund të ndërmerren qasje të ndryshme (një nga aspektet që

shpesh përbën sfidë për punën mes shumë agjencive!). Gabime sigurisht që do të ndodhin. Kjo është pjesë e procesit të të mësuarit. Në këtë rast, trajnuesit duhet të ndërhyjnë për të korrigjuar gabimet e pjesëmarrësve. Kjo bëhet zakonisht përmes injektiveve specifike korrigjuese (shih më poshtë) ose përmes veprimeve virtuale që ndërmerren për riorientimin e pjesëmarrësve. Pjesë shumë të rëndësishme të këtyre ushtrimeve janë informimet në fund të secilës ditë, në të cilat analizohen veprimet e ndërmarra nga ekipet gjatë simulimit dhe diskutohen nevojat për përmirësime. Prioritet është përfundimi i njohurive dhe aftësive dhe jo ndjekja me fanatizëm e skenarit. Është shumë e rëndësishme që trajnuesit t'i japin prioritet më shumë të mësuarit se sa skenarit.

PROFLET E PERSONAZHEVE

Skenari i simulimit përbëhet nga disa personazhe – viktimat, emigrantët vulnerabël, autorët dhe ndërmjetësit e tyre – të portretizuar nga aktorët me të cilët pjesëmarrësit veprojnë gjatë simulimit. Personazhet intervistohen, merren në pyetje, asistohen ose hetohen, në disa raste edhe disa herë. Profilet e personazheve duhet të jenë në përputhje me gjithë historinë e skenarit dhe me veprimet e parashikuara në skenar.

Në mënyrë që aktorët ta luajnë rolin e tyre si duhet gjatë shpalosjes së historisë, nevojiten profile të detajuara të personazheve. Këto profile duhet të përmbajnë informacione që i ndihmojnë pjesëmarrësit ta rindërtojnë historinë dhe të arrijnë objektivat e ushtrimit. Këto profile



Personazhet e ushtrimit simulues të portretizuar nga aktorë.

duhet të përfshijnë sa vijon: një biografi të shkurtër ku përshkruhet origjina e personazhit, historia personale dhe marrëdhëniet; një përshkrim i kushteve të jetesës së personazhit; një përshkrim i sjelljes së personazhit; mendësisë së tij; frikërave; aspiratave; kontaktet/marrëdhëniet me personazhet e tjera; aktivitetet e përditshme, kushtet dhe historitë personale. Për viktimat e huaja të trafikimit, në profil duhet të përfshihet edhe natyra dhe shkaku i secilit hap në viktimizimin e personazhit, duke përfshirë udhëtimin e tyre, rekrutimin, transportimin, shfrytëzimin etj.

Matrica është një mjet vizual ku përmbledhen të gjitha ngjarjet e planifikuara dhe materialet mbështetëse të historisë. Matrica tregon skenat ose ngjarjet e ushtrimit, kohëzgjatjen dhe oraret e tyre, ekipet që do të përfshihen, aktorët që marrin pjesë në skena të veçanta, vendet ku do të ndodhin ngjarjet, si dhe materiale (për shembull, dokumente) që nevojiten për rindërtimin e ngjarjeve. Matricat përbëjnë një mjet të domosdoshëm për trajnuesit në zhvillimin e simulimit dhe ndjekjen e ecurisë së ushtrimit. Është e rëndësishme që ato të mos u bëhen të ditura pjesëmarrësve në trajnim.

Për të ndjekur radhën e ngjarjeve dhe ngarkesën e ekipeve nevojiten afate të caktuara me listat e aktiviteteve për secilin ekip. Hartuesit e ushtrimit duhet të kujdesen gjithashtu që të gjitha ekipet të vazhdojnë të fokusohen dhe të ndihen të përfshirë gjatë gjithë ushtrimit, duke planifikuar veprimet gjatë ushtrimit për secilin ekip përkatës.

ELEMENTËT E NJË MATRICE


VEPRIMET

“Veprimet” janë përshkrimi i ngjarjeve apo skenave specifike të ushtrimit. Për secilin veprim, ka një sërë aktivitetesh, ku përfshihet si informacioni kontribuues (“injektimet”) e trajnerëve dhe përgjigjet që priten nga

pjesëmarrësit. Çdo përgjigje e pritshme lidhet me një objektiv specifik të të mësuarit. Te matricat, është e rëndësishme që të detajohet vendi ku do të zhvillohet veprimi, koha kur pritet që ai të ndodhë dhe kohëzgjatja e veprimit, si dhe çdo artikull/material që nevojitet për simulimin.

INJEKTIMET

“Injektimet” janë pjesë informacioni apo udhëzimi që jepet nga trajnuesit dhe që ka si objektiv një ose më shumë ekipe pjesëmarrësish. Përmes injektiveve, trajnuesit iniciojnë ngjarje të planifikuara në matricë dhe garantojnë zhvillimin e ushtrimit sipas drejtimit të parashikuar. Injektimet mund të jenë me shkrim ose me gojë dhe, në varësi të natyrës së ngjarjes, mund të



Matrica e ushtrimit simulues.

transmetohen në rrugë të ndryshme (për shembull, më telefon, mesazh, email, radio).

Injektimet korigjuese bëhen në të njëjtën mënyrë si injektimet normale, por synojnë rifokusimin e vëmendjes së pjesëmarrësve dhe korigjimin e drejtimit të veprimit në rastet e shmangies nga ajo çka pritet (për shembull, pjesëmarrësit nuk veprojnë në përputhje me procedurat apo me ligjet). Injektimet nuk duhet të pengojnë dhe as të kufizojnë asnjë iniciativë që ndërmerret nga pjesëmarrësit. Pjesëmarrësit duhet të lihen të lirë që të veprojnë në mënyrë autonome në bazë të njohurive dhe aftësive të tyre. Për aq sa është e mundur, të gjitha injektimet duhet të mendohen dhe të planifikohen paraprakisht. Për të mos çenuar realizmin e ushtrimit, injektimet duhet të integrohen natyrshëm në rrjedhën e aktiviteteve (për shembull, ato mund të duken si udhëzime nga drejtuesit e një agjencie të caktuar, etj.).

OBJEKTIVAT E TË MËSUARIT

Çdo veprim duhet të lidhet me një ose disa objektiva të të mësuarit. Përcaktimi i objektivave të të mësuarit është i domosdoshëm për lehtësimin e informimit të pjesëmarrësve në fund të çdo dite trajnimi.


Për shembull, një objektiv kryesor i të mësuarit nga një veprim mund të jetë “kryerja në mënyrë korrekte e monitorimit paraprak të një personi që prezumohet që është i trafikuar”. Ky objektiv përgjithshëm mund të ndahet në disa nënobjektiva: “garantimi i sigurisë dhe privatësisë së viktimës së prezumuar”, “ofrimi i një strehëze të sigurt në përputhje me parashikimet e ...”, etj. Për një model matrice, skenari dhe kuadri ligjor, shih Shtojcën 3.

C MATRICA

Strehëzat duhet të rikrijohen brenda për brenda vendit ku zhvillohet simulimi, duke qenë se si viktimat e prezumuar, ashtu edhe ato të identifikuar, duhet të pajisen me akomodim afatshkurtër. Në përputhje me praktikën më të mirë, këto strehëza duhet të jenë të aksesueshme vetëm për stafin dhe përfituesit e tyre. Megjithatë, mund të jetë e nevojshme që edhe brenda ambienteve të strehëzave të zhvillohet ndonjë veprim (për shembull, intervista).



Rikrijimi i strehëzave brenda për brenda vendit ku zhvillohet simulimi.



Mbledhja e materialeve identifikuese të viktimës së trafikimit.



“Njësia e Policisë” gjatë ushtrimit simulues.

D MATERIALET FIZIKE, VENDI I TRAJNIMIT DHE SHENJAT IDENTIFIKUESE

DOKUMENTET DHE MATERIALET E SIMULIMIT

Për të rikrijuar përvojat e jetës reale, ushtrimet simuluese mbështeten në një numër të konsiderueshëm dokumentesh dhe pajisjesh. Çdo veprim i simulimit kërkon një sërë materialesh dhe vendesh, ashtu sikurse nevojitet në një teatër të tilla si dokumentet e identitetit të personazhit, vërtetimet e pagesave të bëra nga trafikantët, vende të sigurta ku viktima e asistuar

mbrohet, e kështu me radhë. Këto janë të gjitha pjesë e krijimit të një simulimi realist. Materialet e nevojshme për secilin veprim duhet të detajohen në matricë. Të gjitha materialet duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme (ose në vendin ku zhvillohet simulimi ose aty afër). Do të ishte mirë të përgatitet paraprakisht një listë e veçantë e dokumenteve, pajisjeve dhe materialeve të tjera për të parë se çfarë kërkohet dhe kur. Disa prej dokumenteve që nevojitet të përfshihen zakonisht janë:

- Dokumentet që mbajnë me vete aktorët (për shembull, patentë për drejtim automjeti, kartë identiteti, pasaportë, leje qëndrimi);
- Dokumente që mund të gjenden në terren gjatë veprimeve (fatura, regjistra, shënime, etj);

- Dokumente që u janë dërguar pjesëmarrësve nga DIREX (për shembull, formularët për menaxhimin e rastit për personat e asistuar, rezultatet e kërkimeve në baza të dhënash, etj.);

Mund të duhet të përgatiten edhe formularë për disa nga dokumentet imagjinare. DIREX mund të krijojë edhe dokumente të tjera shtesë aty për aty gjatë simulimit si reagim ndaj kërkesave të paparashikuara të pjesëmarrësit (për shembull, informacione administrative), ose korrigjime të veprimeve apo rrugëve të gabuara të ndërmarra nga pjesëmarrësit (për shembull, pjesëmarrësit mund të bëjnë kërkesa që bien në kundërshtim me ligjin).



Njësia e Policisë gjatë ushtrimit simulues vëzhguar dhe nga antarët e DIREX.

VENDI I TRAJNIMIT

Vendi është një pjesë e rëndësishme që duhet menduar në planifikimin e ushtrimeve simuluese. Si historia, ashtu edhe kërkesat logjistike të ushtrimit përcaktojnë atë çka mund të konsiderohet vend i përshtatshëm. Për shembull, për ushtrimet simuluese që përfshijnë një histori që ka të bëjë me shfrytëzimin e punës, ajo çka mund të quhet vend i përshtatshëm mund të ndryshojë nga vendi që kërkon një histori që ka të bëjë me shfrytëzim seksual. Sa i përket nevojave logjistike, organizatorët duhet të vlerësojnë numrin e pjesëmarrësve dhe të trajnerëve që do të përfshihen në ushtrim, nëse pjesëmarrësit do të flenë dhe do të hanë në ambientet e trajnimit, nëse vendi është mjaftueshëm afër me aeroportin, etj.

Ofrimi i akomodimit dhe vakteve të ushqimit në vendin ku zhvillohet trajnimi përbën avantazh me vlerë. Kjo optimizon organizimin, komunikimin dhe mundësitë për pjesëmarrësit që të punojnë së bashku.

Disa kërkesa të tjera bazë që duhen pasur parasysh janë:

Nevojat teknike minimale

Thelbi i ushtrimeve simuluese është komunikimi dhe angazhimi multidisiplinar. Për këtë arsye, për të akomoduar të gjithë pjesëmarrësit për seancat prezantuese dhe për takimet si grup, duhet të ketë një sallë kryesore mbledhjesh. Kështu, agjencitë e ndryshme të përfaqësuara në ushtrimin simulues mund

të mbledhen që të gjitha në të njëjtin vend për diskutime ndërdisiplinare dhe për të mësuar nga njëra-tjetra. Përveç kësaj, duke qenë se komunikimi është vendimtar dhe pjesë e pandashme e ushtrimeve simuluese, është veçanërisht e rëndësishme që të merren masa që të gjitha grupet të mund të komunikojnë brenda për brenda njeri-tjetrit dhe mes njeri-tjetrit (domethënë që të kenë mundësi për të bërë telefonata dhe për të dërguar emaile në të gjitha vendet ku do të zhvillohet ushtrimi).

Ndërkohë që secili ekip ka nevojë për një hapësirë që të mbledhet dhe të bëjë punën e ngarkuar, mundësia për të pasur përfaqësues të secilit grup pjesëmarrësish në një hapësirë të përbashkët ndihmon komunikimin mes grupeve dhe nxit bashkëpunimin mes agjencive të ndryshme. Për shembull, në simulimin shqiptar, u përdor një sallë kryesore me të paktën dhjetë vende pune për DIREX dhe salla të veçanta për Njësinë e Policisë, prokurorinë, Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijës, Shërbimet Sociale, Inspektoriatin e Punës si dhe ambiente të posaçme për strehëzat. Këto u përshtatën në mënyrë që të akomodonin veçmas shërbimet për fëmijë dhe për të rritur si dhe të kishin mjedis të mjaftueshëm për kryerjen e intervistave apo takimet e stafit të strehëzës. Çdo sallë ishte e pajisur me kompjuter, printer dhe mjedise që u përshtatën për intervistimin e rasteve.

Të gjithë kompjuterët e përdorur nga pjesëmarrësit duhet të jenë të lidhur me njëri-tjetrin në mënyrë që pjesëmarrësit të mund të dërgojnë e marrin email-e nga njëri-tjetri, si dhe të ndajnë dokumente brenda për brenda secilit grup. Kjo duhet të bëhet përmes një sistemi Intranet. Për shembull, HICON-ët mund t'i dërgojnë një



Materialet për pjesëmarrësit e ushtrimit simulues.


injeksion Njësisë së Policisë-t, e cila më pas duhet t'ja komunikojë atë strehëzës ose Inspektoriatit të Punës. Ky rrjet duhet të ngrihet dhe të testohet para se të fillojë simulimi. Në rastin e simulimit shqiptar, u krijuan llogari email për secilën njësi dhe hapësirë ruajtjeje virtuale e materialeve të trajnimit.

HICON-ët mund të monitorojnë dhe të mbajnë shënim të gjitha komunikimet me email mes pjesëmarrësve. Kjo praktikë është e dobishme si për kontrollin gjatë veprimeve (për mbikëqyrjen, analizën dhe adresimin e çështjeve në momentin që ato ndodhin), si dhe për të vlerësuar me saktësi drejtimin e veprimeve më pas. Për këtë arsye, pjesëmarrësit duhet ta përdorin email-in sa herë që të jetë e mundur. Është shumë e rëndësishme që në fillim të ushtrimit pjesëmarrësve tu jepen orientime

specifike për komunikimin si dhe të ketë kopje me shkrim të udhëzimeve në çdo sallë.

ÇFARË DUHET BËRË DHE ÇFARË NUK DUHET BËRË MOS EGZAGJERONI!

Ushtrimet e simulimit kanë si qëllim të jenë intensive, ashtu sikurse janë shpesh rastet reale të trafikimit. Megjithatë, trajnuesit duhet të monitorojnë me kujdes fluksin e injeksioneve dhe veprimeve për të garantuar që pjesëmarrësit të mos mbingarkohen me më shumë detyra se sa duhet. Kohëzgjatja e rekomanduar e ushtrimeve simuluese është një javë; hetimet reale të trafikimit të qenieve njerëzore zakonisht kërkojnë disa muaj.



- Përshtatjani simulimin audiencës specifike.
- Përshtatini skenarët dhe historitë sipas kontekstit lokal: sa më realistë të jenë rastet për pjesëmarrësit, aq më shumë do të mësojnë ata prej tyre.
- Përdorni ligjin real si referencë apo si bazë për skenarët tuaj.
- Për të nxitur përdorimin më të gjerë të praktikave pozitive përfshijini ato në ushtrim.
- Trajnojini aktorët.
- Ndërtoni një skuadër të qëndrueshme trajnuesish ekspertë. Kjo është e domosdoshme për punën në grup dhe për të ndihmuar personat që kryejnë funksione të ndryshme, në mënyrë që të punojnë së bashku në mënyrë të efektshme.

PJESA III ZBATIMI I USHTRIMIT

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI AFATIN KOHOR DHE AGJENDËN

Ushtrimet e trajnimit të bazuar në simulim mund të jenë nga më të ndryshmet për nga kohëzgjatja, objektivat, numri i pjesëmarrësve, kompleksiteti i skenarit, burimet e disponueshme, etj. Në bazë të eksperiencës së OSBE-së, kohëzgjatja optimale për këtë trajnim është një javë për përgatitjen dhe një javë për realizimin e ushtrimit, ku përfshihet një ditë prezantimi dhe katër ditë trajnim i bazuar në simulim. Ushtrimi simulues shqiptar u zhvillua përgjatë katër ditëve të plota, nga ora 09:00 deri në 17:00.

JAVA PËRGATITORE

Ndonëse për përgatitje të gjithanshme për një ushtrim njëjavor i bazuar në simulim mund të duhen disa muaj, rekomandohet shumë që të caktohet një javë përgatitore menjëherë para fillimit të ushtrimit. Kjo javë përgatitore përfshin trajnuesit dhe personelin për mbështetje logjistike në mënyrë që ata të përgatisin vendin e trajnimit, të instalojnë dhe të kontrollojnë pajisjet, të përgatisin sistemet IT dhe të komunikimit (telefonat, email etj.), si dhe të bëjnë një përshkrim përfundimtar për aktorët,

Ushtrimet që bazohen në simulime janë, nga njëra anë, të jashtëzakonshëm në dinamikën e tyre, por, nga ana tjetër, mund të jenë edhe të paparashikueshëm. Kjo pjesë mbulon disa prej aspekteve kyçe të realizimit të një ushtrimi, përfshirë një afat kohor të ngjeshur dhe një agjendë për simulimin, elementin e diskutimit vlerësues dhe monitorimin dhe vlerësimin. Idetë që përmban ky kre janë bazuar në përvojën e OSBE-së dhe të partnerëve të saj në organizimin e ushtrimeve të bazuara në simulim. Ato mund të përshtaten në rrethana të ngjashme sipas rastit dhe nevojës.



Trajnimi i Antenave gjatë javës përgatitore.

provat për historitë dhe skenarin, të inspektojnë sallat dhe mjediset, dhe të finalizojnë hollësitë e agjendës.

Simulimet trajnuese të OSBE-së përfshijnë qindra pjesëmarrës (personat që trajnohen, trajnuesit, personat që luajnë rolet, personel mbështetës, etj.) dhe, për rrjedhojë, përballen me një numër të konsiderueshëm sfidash logjistike.

Nisur nga kompleksiteti dhe shkalla e këtyre simulimeve, është shumë e këshillueshme të bëhet një provë e përgjithshme para se të arrijnë pjesëmarrësit në trajnim.

HICON-et, antenat dhe aktorët duhet të jenë të gjithë të pranishëm gjatë kësaj prove. Objektivat që dëshirohen të arrihen për secilin veprim duhet të shqyrtohen e të rishikohen me qëllim që të gjithë anëtarët e skuadrës të jenë duke punuar në kohezion së bashku për të arritur të njëjtët objektiva. Për të siguruar mbarëvajtje sa më të mirë të përgatitjeve, duhet të përgatitet një listë-kontrolli dhe një listë me gjërat që duhen bërë. Si dokument referimi shërben matricën.

Java përgatitore është e rëndësishme edhe për të informuar të gjithë ekspertët për rolet e tyre përkatëse dhe për qartësimin e kanaleve të komunikimit dhe bashkërendimin e përparësive gjatë simulimit.

JAVA E SIMULIMIT

Java e simulimit përfshin një prezantim dhe më pas vetë ushtrimin e bazuar në simulim. Ushtrimet e OSBE-së të bazuara në simulim përmbajnë një ditë prezantim dhe teori dhe katër ditë trajnim të bazuar në simulim. Ushtrimi simulues shqiptar nisi me hapjen zyrtare të trajnimit dhe pjesën teorike. Dita e parë e trajnimit u fokusua në sesione prezantuese dhe ushtrime që forcojnë marrëdhëniet në grup, në mënyrë që pjesëmarrësit të njiheshin me formatin e trajnimit si dhe me pjesëmarrësit e tjerë. Gjithashtu dita e parë u fokusua dhe në shpjegimin e metodologjisë së trajnimit, ndarjen e pjesëmarrësve në grupe dhe shpjegime të tjera të natyrës logjistike. Para fillimit të simulimit, është e nevojshme që të përgatitet

konteksti për pjesëmarrësit në tre hapa: arrihet të fitohet vëmendja e pjesëmarrësve që do të mësojnë, rishikimi i objektivave të trajnimit, sigurimi i një lidhjeje me njohuri të mëparshme.

Shembull

Dita 1: Sesione prezantuese e ushtrimimit simulues në Shqipëri

- Ushtrimi simulues – metodologjia, synimi i pritshëm dhe objektivat e trajnimit. Struktura e trajnimit dhe skenarët
- Identifikimi, referimi, asistenca e viktimave të trafikimit; hetimi i veprës penale. Parimet kryesore, bashkëpunimi ndërinstytucional
- Mënyra e organizimit të trajnimit



Sesioni prezantues i ushtrimimit simulues në Shqipëri.

- Mbërritja e pjesëmarrësve dhe ndarja në njësi
- Drejtuesit e njërive takohen me Ekipin Drejtues të Trajnimit (DIREX)

Sesionet prezantuese në trajnimin e OSBE-së me bazë simulimi në mënyrë tipike përfshijnë një ndërthurje të veprimtarive që vijnë. Është shumë e rëndësishme që t'i kushtohet vëmendje dinamikave për forcimin e ekipit. Një veprimtari e shpejtë për forcimin e dinamikave të skuadrës duhet të realizohet në secilën skuadër trajnimi para se të fillojë simulimi, duke mbajtur parasaysh kontekstin kulturor të pjesëmarrësve. Veprimtari të tilla u mundësojnë skuadrave që të futen në një gjendje performance me fillimin e simulimit. Dedikimi i një periudhe të shkurtër, por të fokusuar, për dinamikën e skuadrës e përshpejton punën në ditën e parë të simulimit në mënyrë të ndjeshme.

REALIZIMI I USHTRIMIT

Historia e simulimit fillon në ditën e dytë. Simulimet e OSBE-së fillojnë me një grup pjesëmarrësish në trajnim që vendosin kontakt me personazhe të përzgjedhur të historisë, si për shembull policia me viktimë të prezumuara apo autorë të dyshuar për vepra penale. Është shumë e rëndësishme që të ruhen me kujdes skënarët e ushtrimit. Për këtë situatë fillestare, personat që trajnohen (të ndarë në skuadra sipas disiplinës përkatëse) sfidohen të kryejnë hetime, procedura administrative dhe gjyqësore, operacione shpëtimi, dhe



Njësia e Policisë arreston një nga trafikantët e dyshuar.



Diskutime të njësive të Policisë para aksionit për kapjen e trafikantëve të dyshuar.

ndërhyrje për asistencë dhe mbrojtje.

Këto hapa do të duhet të vazhdojnë deri sa të jenë identifikuar dhe të jenë kapur autorët.

Gjatë katër ditëve të simulimit aktiv, koha duhet të ndahet në pjesën e “eksperiencës” dhe pjesën e komentimit.

Ditët tipike në trajnimet e OSBE-së ndahen si më poshtë: faza aktive e simulimit është nga ora 8.00 deri në 16.00 (përfshirë një orë pushim për drekë) ndjekur nga një sesion specifik diskutimi vlerësues.

- Diskutimi vlerësues i brendshëm për anëtarët e DIREX;
- Diskutimi vlerësues brenda grupeve (minimumi 45 minuta);
- Diskutimi vlerësues në grup të madh (minimumi 45 minuta);
- Rishikimi i ditës përkatëse të simulimit nga hartuesit e simulimit.

Në ditën e fundit, simulimit i kushtohet një seance përfundimtare diskutimi vlerësues në skuadër dhe në grup të madh që pasohet me plotësimin e formularëve të vlerësimit, si dhe një ceremonie përmbyllëse me dhënien e certifikatave.

ORGANIZIMI DHE NDËRVEPRIMI I TRAJNUESVE GJATË SIMULIMIT

Gjatë një ushtrimi të bazuar në simulim, trajnuesit (përfshirë HICON dhe antenat) do të duhet të vëzhgojnë dhe të monitorojnë nga afër skuadrat e tyre përkatëse. Gjithashtu, ata do të duhet të jenë në kontakt të afërt edhe me njeri tjetrin. Për të lehtësuar komunikimin, rekomandohen disa hapa organizativë. Së pari, siç u theksua më lart, HICON-ët duhet të organizohen në një ekip të përbashkët të quajtur “DIREX”. Kjo mundëson një harmonizim të injeksioneve në të gjitha disiplinat si dhe lehtëson monitorimin. DIREX-i operon në një sallë komandimi nga ku trajnuesit e ndryshëm - të caktuar në

komponentët e tyre përkatës, si për shembull zbatimin e ligjit apo ofrimin e shërbimeve sociale - drejtojnë zbatimin e simulimit. Gjatë zbatimit të simulimit, HICON-ët e DIREX-it - pra, trajnuesit - nxisin veprime nga një vendndodhje e ku pjesëmarrësit në trajnim nuk kanë akses, salla e komandimit, dhe monitorojnë reagimet e pjesëmarrësve.

Nga vendet e tyre të punës, që janë të pajisur me kompjutera dhe telefona, anëtarët e DIREX-it lidhen me vendet e punës të skuadrave të tyre përkatëse dhe mund të monitorojnë komunikimet elektronike midis anëtarëve të skuadrës në kohë reale. Gjithashtu ata marrin dokumentet dhe përgjigjet nga pjesëmarrësit në trajnim, si dhe përditësimet nga antenat. HICON-ët nuk ndërveprojnë me pjesëmarrësit ballë për ballë.



Diskutime të brendshme të anëtarëve të DIREX.



Diskutime të brëndshme të anëtarëve të DIREX.

Komunikimi midis skuadrave dhe DIREX-it gjatë simulimit, i gjithë komunikimi që në jetën reale të pjesëmarrësve në trajnim normalisht do t'i dërgohej në autoriteti më të lartë ose një organi koordinues, duhet të dërgohet te DIREX. I gjithë komunikimi midis pjesëmarrësve në trajnim dhe DIREX-it duhet të bëhet nëpërmjet mjeteve elektronike.

Shembull:

Njësia e Policisë (NjP) duhet të kërkojë miratimin e prokurorit për një ndërhyrje në një lokal ku dyshohet se ka viktima trafikimi. Në këtë rast, pjesëmarrësit në trajnim duhet t'i dërgojnë një kërkesë HICON-it të NjP-së, që e shqyrton kërkesën. Komunikimi mes/ndërmjet skuadrave duhet të zhvillohet në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe jo nëpërmjet HICON-ëve.

Shembull:

Nëse NjP-ja ka nevojë të komunikojë me një strehëz, atëherë NjP-ja i dërgon strehëzës një e-mail drejtpërdrejt, pa qenë nevoja të kalojë nëpërmjet HICON.

ROLI I ANTENAVE SI “SY DHE VESHË” GJATË SIMULIMIT

Siç u vu në dukje më lart, DIREX-i operon nga një sallë komandimi dhe ndihmohet nga antenat - vëzhgues që fizikisht ndjekin secilin grup me persona që trajnohen dhe shërbejnë si “sy dhe veshë” të HICON-ëve. Antenat janë ngarkuar për të monitoruar veprimet dhe raportimin pranë HICON-it në kohë reale në lidhje me çfarë po ndodh në skenën e simulimit. Në këtë mënyrë, HICON-ët mund të ndjekin ecurinë e personave që trajnohen gjatë zhvillimit të simulimit. Kjo u mundëson HICON-ëve edhe që t'u dërgojnë skuadrave komente feedback në kohë reale, në varësi të asaj që ndodh aktualisht në skenë.



Diskutime vlerësuese në fund të ditëve të ushtrimit të simulimit.



Bashkëpunimi midis agjencive në intervistimin e një fëmijë viktimë trafikimi.

Për shembull, antenat po monitorojnë një takim midis Përgjegjësit të NjP-së dhe Prokurorisë gjatë së cilit merret vendim se duhet paraqitur një kërkesë tek gjyqtari. Antena e përcjell këtë informacion tek HICON-i, duke i mundësuar këtij të fundit t'i paraprijë kërkesës për autorizim, të cilën skuadra e Prokurorisë me gjasë do e dërgojë në fund të takimit si dhe të përgatisë përgjigjen për gjyqtarin. Komunikimi midis HICON-it dhe antenës realizohet në mënyrë tipike me anë të tekstmesazheve.

Antenat duhet të caktohen pranë çdo skuadre (p.sh. policia, prokuroria, etj.); numri i antenave për skuadër varet nga numri i anëtarëve pjesëmarrës në atë skuadër. Nëse, për shembull, një skuadër ndahet për të ndjekur

pista të veçanta hetimi, do të ishte e domosdoshme që të paktën një aktën të ndiqte secilin grup. Antenat nuk duhet të ndërveprojnë me pjesëmarrësit në trajnim. Roli i tyre është të monitorojnë pa ndërhyrë në simulim. Pjesëmarrësit në trajnim duhet të informohen për rolin e antenave dhe modalitetet e veprimtarive të tyre, sepse përndryshe ata mund të përpiqen t'u drejtojnë pyetje antenave gjatë ushtrimit. Në rastet kur është absolutisht e domosdoshme, një HICON mund t'i kërkojë antenës të ndërhyjë për të ndihmuar në zgjidhjen e një problemi që ndryshe nuk mund të zgjidhej, por këto ndërhyrje duhet të jenë ekstremisht të rralla dhe të zbatohen me kujdes.

VEPRIME VIRTUALE

Ekziston mundësia që pjesëmarrësit në trajnim të kenë nevojë të vendosin kontakt me institucione apo autoritete të tilla si shërbimet shëndetësore apo gjykatat, të cilat nuk përfshihen në disiplinat që marrin pjesë në ushtrim.

Për shembull, për të arritur qëllimet e tyre, pjesëmarrësit mund të kenë nevojë të kontaktojnë me një ambasadë, ose një OJQ që ndodhet në një shtet tjetër. Për të trajtuar këtë nevojë, simulimet e OSBE-së kanë edhe në subjekt virtual brenda DIREX-it që mund të kontaktohet nga pjesëmarrësit në trajnim.

Për këtë rol, gjatë ushtrimit, duhet të caktohet një ekspert ekskluzivisht vetëm për këtë rol. Ky person preferohet të ketë përvojë gjyqësore, duke qenë se kërkesat e këtij lloji janë me karakter gjyqësor (p.sh. kërkesë për autorizim për kontroll banese). Eksperti i caktuar vepron më pas në emër të autoriteteve ose institucioneve fiktive, të cilat nuk janë të përfaqësuara në simulim, qoftë në shtetin ku po zhvillohet simulimi (shërbimet shëndetësore, gjykatat, etj.) qoftë në shtete të tjera të përshkuara në historinë e përgjithshme (ambasada, OJQ të huaja, etj.). Eksperti përgatit një përgjigje ndaj kërkesës dhe ia kthen këtë komunikim skuadrës përkatëse.

DISKUTIMET

Diskutimet vlerësuese janë ndër elementet më të rëndësishëm të ushtrimeve të simulimit. Këto diskutime organizohen nga trajnuesit në fund të çdo dite të ushtrimit të simulimit për të shqyrtuar ecurinë dhe për të diskutuar përmirësimet. Konteksti për diskutime të frytshme përcaktohet çdo mëngjes nga HICON-ët, që i paraqesin skuadrës së tyre një listë me objektiva kyç për atë ditë. Kjo u lejon trajnuesve të përcjellin një mesazh të qartë në lidhje me pritshmëritë, çka orienton punën e skuadrave gjatë ditës. Në fund të ditës, trajnuesit mund t'u rikujtojnë skuadrave objektivat e mësimit gjatë asaj dite. Kjo lehtëson diskutimin midis personave që trajnohen: analizimi dhe zgjidhja e sfidave që janë hasur, njohja e asaj që funksionoi mirë dhe asaj që mund të përmirësohet, dhe përmbledhje e mesazheve kyçe të të mësuarit.

Kjo fazë e procesit zhvillohet së pari në skuadra dhe më pas me të gjithë grupin e madh të pjesëmarrësve. Objektivat e të dy sesioneve ndryshojnë nga njëri tjetri. Gjatë diskutimeve brenda skuadrës, fokusi kryesor duhet të jetë te performanca e skuadrës.

Gjatë diskutimeve në grup të madh (d.m.th. me shumë disiplina të përfshira), fokusi duhet të jetë tek bashkëpunimi midis agjencive: pse është i vlefshëm, cilat hapa praktike duhen përmirësuar gjatë ushtrimit.



Diskutim i ditës së parë të simulimit.

Diskutimet duhet të zhvillohen me kujdes. Organizimi i sesioneve të diskutimit pa një metodë, përfshirë komentet feedback për skuadrat, pa lehtësuar procesin e të nxënit nëpërmjet një diskutimi të drejtuar, e dëmton vlerën e trajnimit të bazuar në simulim. Debatet duhet të jenë të strukturuar dhe, ndonëse komentet feedback janë të nevojshme, duhet të lejohen të kontribuojnë edhe pjesëmarrësit me perceptimet dhe përvojat e tyre.

Është tejet e rëndësishme që të rezervohet një kohë e mjaftueshme për diskutimet duke mbajtur parasysh se, në mënyrë që të jenë të efektshme, trajnimet e bazuara në simulim kërkojnë një proces të strukturuar dhe teknika specifike trajnimi dhe lehtësimi.

PËRGATITJA DHE ORGANIZIMI I DISKUTIMEVE VLERËSUESE

HICON-ët duhet t'i planifikojnë diskutimet vlerësuese me kujdes dhe me mbështetje nga antenat. Antenat mund të sjellin vlerë të shtuar në këto diskutime mbështetur në vëzhgimet e tyre gjatë ditës. Ata mund të ndihmojnë aktivisht për realizimin e diskutimeve me HICON-in e tyre përkatës. Ekspertët/trajnuesit/lehtësuesit (HICON-ët dhe SHEFI i EXCON) duhet të jenë ata që drejtojnë diskutimet, duke sjellë informacionin përkatës në secilën fazë të procesit dhe duke përdorur si udhërrëfyes objektivat e përcaktuar për trajnimin e ditës përkatëse. HICON-ët kanë përgjegjësinë për të siguruar që mësimit



Diskutime të brendshme të anëtarëve të DIREX.

e marra dhe përfundimet e secilit sesion diskutimi të përmbledhen në mënyrë të qartë dhe të mund të artikuloen nga skuadrat.

Gjatë kësaj faze, roli i trajnuesve është të ndihmojnë secilën skuadër që të reflektojë mbi atë që ka ndodhur gjatë pjesës së “eksperiencës” së simulimit dhe se çfarë kanë mësuar nga kjo. Përveç prezantimit të objektivave të ditës për skuadrat, HICON-ët duhet të jenë në gjendje të shtrojnë pyetje që nxisin të menduarit gjatë diskutimeve në skuadër si dhe gjatë diskutimeve në grup të madh ku të pranishme janë shumë disiplina, si dhe të përmbledhin mesazhet me mësimet kryesore në fund të çdo dite.

Faza e parë e procesit të të mësuarit, ose eksperiencën, është në qendër të trajnimit dhe në simulimet e OSBE-së zë pjesën më të madhe të kohës së caktuar. Koha që rekomandohet për eksperiencën, bazuar në vlerësimet dhe rishikimet e metodologjisë, është rreth 5 deri në 6 orë në ditë. Fazat 2 (reflektimi), 3 (përgjithësimi), dhe 4 (zbatimi) zhvillohen gjatë sesioneve të diskutimeve vlerësuese që kanë caktuar për në fund të çdo dite (duke nisur nga dita e dytë e trajnimit). Në bazë të përvojës së OSBE-së, mbledhja e anëtarëve të skuadrës, trajtimi i temave përkatëse dhe mundësimi diskutimit, kërkon të paktën 45 minuta për diskutimet në skuadër dhe 45 minuta për diskutimet në grup të madh.

Meqë simulimet organizohen në hapësira të mëdha, duhet të llogaritet koha që u duhet skuadrave për të lëvizur brenda mjediseve të trajnimit (p.sh. nga vendi i punës në sallën plenare) në mënyrë që të mos reduktohet koha e përcaktuar për diskutimet. Kjo merr rëndësi të veçantë në rastet kur disa skena ndodhin jashtë mjediseve të trajnimit (p.sh. në një fabrikë apo në një apartament).

SEKUENCA DHE KORNIZA KOHORE E DISKUTIMEVE

Sekuencat e seancave të diskutimit në skuadër dhe në grup të madh është e njëjtë: të dyja këto seanca duhet të përfshijnë fazat 2, 3 dhe 4 të procesit të të mësuarit nga eksperiencën.

Monitorimi i ecurisë së simulimit

Qëllimi kryesor i simulimit është trajnimi i pjesëmarrësve për të luftuar në mënyrë të efekshtme trafikimin e qenieve njerëzore nëpërmjet një qasjeje që përfshin shumë agjenci. Ky është një qëllim kompleks që duhet të ndahet më tej në shumë objektiva të tjerë specifikë, ku të gjithë këta objektiva të monitorohen në mënyrë të vazhdueshme gjatë simulimit. Simulimi u mundëson personave që trajnohen të kuptojnë më mirë rolet dhe përgjegjësitë e tyre përkatëse brenda sistemit të reagimit anti-trafikim, të kuptojnë potencialin e plotë të bashkëpunimit të efektshëm për të arritur rezultate

nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të tyre individuale, dhe për të vepruar si pjesëtarë të një skuadre të lidhur.

Simulimet i ndihmojnë pjesëmarrësit në trajnim që të punojnë me shkëmbimin e informacionit midis institucioneve të ndryshme, duke përmirësuar cilësinë e komunikimit, duke i vendosur veprimtaritë sipas përparësisë, dhe duke zbatuar praktikën më të mirë.

Monitorimi i veprimeve gjatë ekzekutimit të tyre është me rëndësi kyçe për identifikimin e sfidave që përjetojnë pjesëmarrësit në trajnim dhe për trajtimin e këtyre sfidave në një format bashkëpunimi. Monitorimi i vëmendshëm është po ashtu i rëndësishëm për gjurmimin e veprimeve dhe përgatitjen e injeksioneve në kohë. Rekomandohet që organizatorët të planifikojnë një sistem (digjital ose manual) për të monitoruar ecurinë nëpërmjet një matrice në kohë reale, përfshirë veprimet që ndodhin aktualisht nga ana e skuadrave apo injektimet e pritshme në të ardhmen.

Antenat, që dokumentojnë ecurinë e skuadrave përkatëse, shërbejnë si një prej funksioneve parësore monitoruese në simulime. Për të mbështetur detyrat të tyre monitoruese, duhet të përgatiten dhe të shpërndahen formularë monitorimi. Këta formularë i ndihmojnë antenat të regjistrojnë, në bazë ditore, vlerësimet e tyre për

veprimtaritë që ndërmerren nga personat që trajnohen përkundrejt objektivave të përcaktuar. Formularët e monitorimit janë të dobishëm edhe për përmirësimin e formateve të trajnimit, dhe mund të shfrytëzohen nga trajnuesit për të përmirësuar përvojën e përgjithshme të të nxënësve.

VLERËSIMI I NDIKIMIT DHE ANALIZIMI I REZULTATEVE

Për të përcaktuar ndikimin e një ushtrimi, si dhe për të mbledhur informacion të vlefshëm për ushtrime në të ardhmen, sugjerohet që të prodhohen vlerësime cilësore dhe sasore. Gjatë ushtrimit të simulimit, gjenerohen disa burime me informacione të dobishme, si më poshtë:

Të gjitha komunikimet elektronike që shkëmbehen gjatë simulimit. Të gjitha të dhënat, dosjet, dokumentet, dhe e-maillet që janë krijuar dhe janë shkëmbyer midis palëve gjatë një simulimi duhet të ruhen nga qendra e trajnimit dhe të analizohen nga trajnuesit gjatë dhe pas ushtrimit.

Formularët e monitorimit që plotësohen nga antenat, siç u vu në dukje më lart.

Formularët e vlerësimit nga pjesëmarrësit: Në fund të trajnimit, çdo pjesëmarrës duhet të marrë një formular gjithëpërfshirës vlerësimi, me objektivat e të nxënësve

si dhe aspekte të tjera të organizimit dhe logjistikës. Formularët e vlerësimit që përdor OSBE-ja janë anonimë dhe mund të mbledhin të dhëna edhe në lidhje me cilësinë e sesioneve prezantuese, përjetimin e përgjithshëm të pjesëmarrësve, si dhe njohuritë kryesore që morën nga trajnimi (njohuri dhe aftësi që fituan, në lidhje me punën e tyre të përditshme, rekomandime). Këshillohet që të sigurohet mundësia që pjesëmarrësit në trajnim ta kthejnë formularin e plotësuar të vlerësimit pranë organizatorëve gjatë sesioneve përmblyëse. Këto të dhëna më pas mund të kategorizohen dhe të analizohen për të marrë informacion cilësor dhe sasior. Disa shembuj përfshijnë analizimin e të dhënave sipas skuadrave, gjinisë, pyetjeve, etj.

Raportimet/komentet feedback nga trajnuesit:

Pas trajnimit, këshillohet që t'i kërkohet secilit trajnues që të hartojë një raport konciz bazuar mbi vëzhgimet e tyre dhe se çfarë do të përmirësonin ata në ushtrimin e radhës. Është e rëndësishme që ky informacion të sintetizohet në një "plan përmirësimi". Planet e mësimi dhe përmirësimit mund të shpërndahen te aktorët kyç për të planifikuar trajnime simulimi në të ardhmen.

KËSHILLA MBI ÇFARË MUND TË BËHET DHE ÇFARË NUK DUHET TË BËHET

- Planfikoni sa më shumë të jetë e mundur.
- Mos prisni që gjerat të shkojnë gjithmonë sipas planit.
- Përgatituni për veprime dhe injektive ad hoc (në DIREX, me organizatorët, me aktorët dhe antenat), po gjithmonë mbani parasysh objektivat e ushtrimit dhe veprimet.
- Merrni vendime si ekip në DIREX, sidomos kur prezantoni një injektim të paplanifikuar korrigjues.
- Mbajini pjesëmarrësit të përfshirë dhe të fokusuar.
- Mos e nënvlerësoni kohën që nevojitet për diskutimet vlerësuese dhe vlerën e tyre në procesin e të mësuarit.
- Jini vigjilentë dhe të gatshëm për të trajtuar ndjeshmëri kulturore, politike, profesionale dhe me bazë gjinore.

SHTOJCAT

PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM - MATRICAT - PROFILET - SKENARI

PROFILI I PERSONAZHEVE	
TRAFIKANTËT/KRIMINELËT/VIKTIMAT	
Emri/Mbiemri	
Mosha:	
Vendlindja:	
Të dhënat penale:	
Numër telefoni:	

VEPRIMI 1		
KONTEKSTI		
DATA:	VENDNDODHJA:	KOHA:
SKENARI		
AKTIVITETET	INJEKSION: PRITSHMËRIA	
INJEKSION		
OBJEKTIVAT		
PERSONA		MATERIALE
AKTORËT	PAJISJE	
PJESËMARRËS NË TRAJNIM	DOCUMENTACIONI	

FORMULAR VLERËSIMI NGA PJESËMARRËSIT

A. TË DHËNA MBI KONTEKSTIN

1. Si u informuat për këtë ushtrim simulimi?	Facebook	Twitter	Website i OSBEsë	Caktim nga eprori	Kolegë	Miq	
2. Në cilin rol/njësi morët pjesë në ushtrimin e simulimit?	Policia	Prokuroria	Inspektoriati I Punës	Mbrojtja Sociale	Strehëza	Shërbimi i emergjencës për fëmijë	Tjetër
3. A punoni në këtë rol (ose të ngjashëm) në jetën reale?	Po	Jo					
4. Nëse jo, cili është pozicioni juaj në punën tuaj normale?							

B. SESIONET TEORIKE

5. Sa të dobishme ishin për ju prezantimet hyrëse të ushtrimeve? (referohuni më poshtë)	Shumë të dobishme	Mjaft të dobishme	Mjaftueshëm (as shumë, as pak)	Aspak të dobishme
6. Ushtrimi simulues – metodologjia, synimi i pritshëm dhe objektivat e trajnimit. Struktura e trajnimit dhe skenaret				
7. Viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore: parimet kyçe të identifikimit, referimi dhe asistenca, specifikat e punës me fëmijët viktimë të trafikimit				
8. Mënyra e organizimit të trajnimit				
9. Refelektimi (debriefing)				
Komente për pjesën e përgjithshme gjatë ditës së parë?				

C. PAS USHTRIMIT TË SIMULIMIT

	Po	Në pjesën më të madhe	Jo shumë	Jo
10. A arritët të kuptoni më mirë sfidat që paraqiten nga skenarët e jetës reale kur ndesheni me raste komplekse trafikimi të qenieve njerëzore?				
Nëse jo, pse? Komente të përgjithshme				
11. A arritët të forconi aftësitë për të ndërvepruar në mënyrë pozitive me aktorë të tjerë në faza të ndryshme të proceseve të antitrafikimit, dhe të ofroni ndërhyrje mbështetjeje për personat e trafikuar nga një këndvështrim ku përfshihen shumë agjenci?				
Nëse jo, pse? Komente të përgjithshme				

12. A e ka forcuar ushtrimi i simulimit aftësinë tuaj për të identifikuar pa vonesa viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore dhe për të zbatuar si duhet SOP-të të bazuara te të drejtat e njeriut për identifikimin dhe asistencën për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit?

Nëse jo, pse? Komente të përgjithshme

13. A ju ndihmoi ushtrimi i simulimit të zgjeroni njohurinë e përgjithshme mbi strukturat e ndryshme që përfshihen në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore?

Nëse jo, pse? Komente të përgjithshme

D. KONTEKSTI KU ZHVILLOHET USHTRIMI I SIMULIMIT

	Po	Në pjesën më të madhe	Jo shumë	Jo	Nëse jo, pse? Komente të përgjithshme (vijo më poshtë)
14. A u shpjegua mjaftueshëm ushtrimi simulues në lidhje me kontekstin dhe procedurat? P.sh. a u shpjeguan si duhet rolet e të gjithë komponentëve? A u bënë të qartë gjatë ushtrimit?					
15. Në ushtrimin e simulimit, a kishit mundësi të mjaftueshme për të ndërvepruar me komponentë/kolegë të tjerë gjatë ushtrimit?					
16. A kishit raste të mjaftueshme për të shkëmbyer eksperiencë të jetës reale që kanë lidhje me luftën kundër TQNj me pjesëmarrës të tjerë, përfshirë jashtë ushtrimit? Nëse po, përgjigju dhe pyetjes 18.a.					
17. A ndiheni më të pajisur për të kryer hetime THB bazuar në një qasje që mban parasysh të drejtat e njeriut dhe ka viktimën në qendër?					

18. A ishte kuadri ligjor për ushtrimin e simulimit i shpjeguar mjaftueshëm në dokumentet e dhëna?					
19. Si do ta vlerësonit organizmin e ushtrimit të simulimit në tërësi?					
Komente të përgjithshme					

E. LOGJISTIKA

	E shkëlqyer	Mirë	Çka	Dobët	Për komente për logjistikën përdorni kutinë më poshtë
20. Si do ta vlerësonit mbështetjen logjistike që ju dha para dhe gjatë ushtrimit të simulimit? (Transporti, etj.)					
A keni sugjerime apo rekomandime të tjera për mbështetjen logjistike që u dha para dhe gjatë ushtrimit të simulimit?					

